

be  sms

...qasje e lehtë në xhirollogarinë tuaj!

Banka Ekonomike edhe me një shërbim të ri për ju!

be  sms

GJENDJA E LLOGARISË SUAJ NË SMS!

 Banka
Ekonomike

Ne avansojmë biznesin tuaj

Kush jemi Ne

Vizioni ynë është që të bëhemi bankë udhëheqëse në plotësimin e nevojave të klientëve.

Për të arritur atë, ne kemi krijuar politikat për të gjithë palët që përbëjnë aktivitetin tonë:

Për klientët - t'ju ndihmojmë atyre që të realizojnë atë që kanë planifikuar

Për të punësuarit - të krijojmë një ambient ku të gjithë do të tregojnë kualitetet e tyre punuese.

Për shoqërinë - të krijojmë një ndryshim të vërtetë pozitiv

Për aksionarët - të gjenerojmë dobi më të lartë nga investimet e tyre, sesa mesatarja e dobive në bankat e tjera.

PËRMBAJTJA

05-06 *Fjala përshëndetëse e Drejtorit Gjeneral*

07-10 *Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare*

- › Produkti i Brendshëm Bruto (GDP)
- › Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore
- › Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet
- › Inflacioni
- › Tregtia e jashtme
- › Papunësimi
- › Sistemi bankar dhe financat

11-18 *Vështrim mbi afarizmin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2006*

- › Numri i llogarive të klientëve
- › Depozitat
- › Kreditimi
- › Qarkullimi i pagesave
- › Të ardhurat dhe shpenzimet
- › Zgjerimi dhe modernizimi

19 *Këshilli Drejtues. Drejtuesit*

20 *Bankat korrespondente*

21-22 *Raporti i auditorëve të pavarur*

23-51 *Pasqyrat financiare*

“Ne besojmë se një kompani e suksesshme gjeneron dobi të vazhdueshme për aksionarët si dhe krijon ndryshime pozitive në shoqëri”



Hajrullah Zaiti, Drejtor Gjeneral

Zonja e zotërinj, bashkëpunëtorë të nderuar,

Viti 2006 ishte viti i pesëmbëdhjetë i punës së suksesshme të Bankës Ekonomike dhe viti i gjashtë i Bankës pas licencimit nga UNMIK-u gjegjësisht Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës.

Banka Ekonomike prej licencimit ka punuar me sukses të mirë, duke krijuar reputacionin dhe imazhin e bankës së suksesshme dhe të besueshme për depozitorët dhe aksionarët. Edhe pse punohet në një treg financiar ende të pa rregulluar, ku më tepër ndikim kanë faktorët e natyrës subjektive se sa rregullat e tregut, Banka Ekonomike, në vazhdimësi, ka punuar me tregues pozitiv dhe stabilitet të plotë.

Predispozitat e afarizmit më të suksesshëm nënkuptojnë shkallë më të avansuar të ekonomisë dhe standardit të qytetarëve, që aktualisht janë në nivel të ulët, pasi, siç dihet, Kosova është i vetmi vend i Europës Juglindore, pa investime serioze. Investimet pas luftës, kryesisht janë përqëndruar në meremetimin e objekteve të shkatërruara nga lufta. Sektori privat është zhvilluar në mënyrë ekstensive. Me një fjalë i është lënë investitorëve që sipas ideve të tyre të zhvillojnë biznesin, i cili në përgjithësi karakterizohet me ndërtimin e objekteve të sektorit

terciar, pa pasur ndonjë plan dhe orientim të qartë të zhvillimit. Kosova është shndërruar në treg për vendet e rajonit e më gjërë.

Transformimi pronësor apo privatizimi është kapitull në vete, i cili është kryer si model i panjohur dhe me pasoja të rënda ekonomike shoqërore dhe sociale. Na mbetet shpresa që pas zgjidhjes së Statusit të Kosovës do të bëhen përpjekje për ndryshimin e strukturës ekonomike. Zhvillimet e mirëfillta, në të ardhmën, korrespondojnë me investime në prodhimtari, që deri diku të kompenzohet ngecja 20 vjeçare.

Mbetem me shpresë që kapitali vendor, e posaqërisht ai i huaj do të zgjedh rrugën që shkon në drejtim të prosperitetit, duke e ndërlidhur interesin e investitorëve me zhvillimin e përgjithshëm ekonomiko-shoqëror të Kosovës.

Vend dhe rol të veçantë do të ketë edhe industria bankare, e në kuadër të saj edhe Banka Ekonomike.

Banka Ekonomike ka punuar me sukses në vazhdimësi, duke rritë depozitat, nivelin e kredive, kapitalin e Bankës, zgjerimin e bazës materiale, numrin e klientëve, hapjen e njësisive të reja dhe përfshirjen e afarizmit në të gjitha qendrat e rëndësishme të Kosovës, zgjerimin e produkteve të reja, aftësimin e kuadrove, etj.

Banka në vazhdimësi ka pasur kujdes në zbatimin e drejtë të ligjeve në fuqi, rregulloreve e rregullave të AQBK (në lëmitë dhe rastet e caktuara, rregullat e AQBK ishin shumë më rigorozë se standardet ndërkombëtare) dhe akteve e vendimeve të Bankës. Kujdes i veçantë i është kushtuar përmirësimit të kushteve të kreditimit, brenda rregullave dhe lëvizjeve të tregut financiar, duke përkrahur sektorin privat; përkrahjen e biznesit të vogël e të mesëm, ekonomitë familjare, etj. Me këto veprime është zgjatë maturiteti i kredive, në kuadër të mundësive dhe realitetit ekzistues në tregun financiar. Vënia në funksion e kartelave kredituese në tërë territorin

e Kosovës, është hap përpara, që reflekton një pozicion të favorshëm të Bankës në treg. Klientët e Bankës i shfrytëzojnë edhe kartelat kredituese "American Express".

Me Bankën Ekonomike punojnë ndërmarrjet më të suksesshme të Kosovës. Një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë, këto ndërmarrje e mbështesin dhe kryejnë me Bankën Ekonomike: kredi, transfere të brendshme e të jashtme, etj.

Rëndësi të veçantë, Banka i ka kushtuar teknologjisë informative; aftësisimit të kuadrove të reja dhe atyre ekzistuese, me programe adekuate e të vazhdueshme, brenda bankës, apo nëpërmjet Shoqatës së Bankave të Kosovës, AQBK, etj. Në këtë drejtim janë bërë investime të konsiderueshme, kurse aftësimi dhe trajnimi i personelit, në të ardhmen, mbetet në krye të listës së prioritetëve të Bankës. Poashtu, me prioritet është intensifikimi i aktiviteteve të bashkëpunimit në relacion me bankat në vend dhe të jashtme.

Banka Ekonomike në fund të vitit 2006 ka

**Banka Ekonomike
në fund të vitit
2006 ka realizuar
rritjen e aktives për
15%, kurse fitimi
bruto ishte për
71,2% më i lartë se
në vitin paraprak.**

**Numri i klientëve
është rritur nga
34.105 në 42.065.**

realizuar rritjen e aktives për 15%, kurse fitimi bruto ishte për 71,2% më i lartë se në vitin paraprak.

Numri i klientëve është rritë nga 34.105 në 42.065.

Banka në vitin raportues ka realizuar qarkullimin e pagesave brenda dhe jashtë vendit në shumën 277,10 mil euro.

Edhe treguesit kryesor që maten sipas standardeve ndërkombëtare janë të volitshëm.

Auditimi i jashtëm është bërë nga KPMG.

Bashkëpunëtor të ndëruar, këto rezultate i kemi arritur duke ju falenderuar të gjithë klientëve të Bankës dhe bashkëpunëtorëve tjerë, në një konkurrencë tepër të fortë.

Menaxhmenti i Bankës i shprehë Këshillit Drejtues falenderim të singertë për korrektesë dhe unitet në të gjitha fazat e bashkëpunimit me Menaxhmentin e Bankës, sidomos në aprovimin dokumenteve strategjike të Bankës me konsensus të plotë. Mirënjohje dhe falenderim i veçantë i dedikohet kryetarit të gjertanishëm të Këshillit Drejtues, z.Bardhyl Minxhozi, i cili me përkushtim e ka drejtuar dhe udhëheqë punën e Këshillit Drejtues.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e gjertanishëm, ju ftoi për vazhdimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve tona afariste, në të ardhmen.

Drejtori Ekzekutiv
Hajrullah Zaiti

2. Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë kosovare

Ekonomia kosovare pas përfundimit të luftës në qershor të vitit 1999 e deri në fund të vitit 2006 karakterizohet me rindërtimin e shtëpive dhe objekteve të banimit të djegura, rrugëve dhe urave, ambulancave, shkollave, zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë dhe jashtë ekonomisë, krijimin e sistemit bankar me Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës dhe 6 banka komerciale, fillimin e procesit të privatizimit me intensitet të shtuar në dy vitet e fundit, investime në sektorin e energjetikës, kryesisht nga donacionet e bashkësisë ndërkombëtare, mos zgjedhjen e Statusit të Kosovës, që rezultoi në nivel të ulët të zhvillimit ekonomik.

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, në bazë të rritjes së ulët të produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori ndikoi në rritjen e vazhdueshme të papunësisë dhe moszgjidhjen e statusit të penzionerëve.

Edhe në vitin 2006 është shënuar niveli i ulët i zhvillimit ekonomik. Prodhimi i brendshëm bruto për kokë banori ishte ndër më të ultin në rajon, ndërsa përqindja e papunësisë ishte më e larta (55-60 %) me tendencë të keqësimit. Mbulesa e importit të mallrave dhe shërbimeve me eksporte në fund të vitit 2006 ishte e ulët (6.0 %), për shkak të varësisë së ekonomisë kosovare nga importet, që tregon nivelin e ulët të zhvillimit global dhe struktural të ekonomisë.

Buxheti i Kosovës i formuar nga të hyrat vetanake (kryesisht nga dogana dhe taksat) në fund të vitit 2006 shenoi suficit prej 77.5 mil. euro, në krahasim me deficitin e realizuar në fund të vitit paraprak në shumë prej 60,9 mil. euro. Suficiti i realizuar ishte më tepër rezultat i nivelit të ulët të pagave dhe mosrritjes së tyre në sektorin e arsimit, shëndetësisë, policisë dhe administratës buxhetore.

Mosaktivizimi i shumë ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara, krahas investimeve të vogla në industri e bujqësi, niveli i ulët i pagave të punëtorëve në sektorin publik që financohet nga buxheti, sektorin

privat, pensionet e ulëta në nivel të ndihmës prej 40 euro, përveç disa faktorëve tjerë, ndikoi në rënien e vazhdueshme të aftësisë blerëse të popullsisë dhe qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve, duke vështirësuar afarizmin e bizneseve dhe rritur varësinë e tyre prej kredive të bankave komerciale dhe institucioneve financiare të Kosovës.

2.1. Produkti i brendshëm bruto (GDP)

Niveli i ulët i Produktit të brendshëm bruto (GDP) për kokë banori është tregues i nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës pas luftës së vitit 1999 e deri në fund të vitit 2006 dhe krahasuar me vendet e rajonit Kosova është vendi më i pazhvilluar.

Niveli i produktit të brendshëm bruto për kokë banori në periudhën pesëvjeçare 2002-2006, ishte më i larti në vitin 2002 (1.288 euro) ndërsa në fund të kuartalit të tretë të vitit 2006 është realizuar në shumë prej 1.117 eur. ose për 0.3 % më i ulët se në vitin paraprak.

Realizimi i Produktit të brendshëm bruto në Kosovë në këtë nivel të ulët është rrjedhim i disa faktorëve kryesor: mungesës së prodhimit vendor, investimeve të huaja, mospërfundimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore e mosaktivizimit të shumë ndërmarrjeve të privatizuara, rënies drastike të donacioneve të bashkësisë ndërkombëtare dhe moszgjidhjes së statusit të Kosovës. Në formimin e produktit të brendshëm bruto më së shumti kanë ndikuar tre faktorë: importet, asistenca e huaj dhe dërgimi i mjeteve:

Produkti i brendshëm bruto¹⁾

Përshkrimi/ Periudha	2002	2003	2004	2005	2006
GDP (në mil. euro)	2.447	2.420	2.282	2.238	2.270
GDP për banorë (në euro)	1.288	1.252	1.161	1.120	1.117
Dërgesat e punëtorëve (në mil. eur)	341	341	215	281	318
Ndihma nga jashtë (në mil. euro)	887	688	565	491	465
Kontributi i drejtëpërdrejtë i ndihmës (në mil. euro)	484	393	200	208	203
Popullsia (në 000)	1.900	1.932	1.965	1.999	2.015

1) Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës: "Monthly Statistics Buletins" janar/07

2.2. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore

Agjensia Kosovare e Mirëbesimit e ka filluar procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore më 15 Maj 2003. Procesi i privatizimit deri më 31 dhjetor 2004 ishte i ngadalësuar me ndërprerje të përkohshme dhe rezultoi me privatizimin e 40 ndërmarrjeve shoqërore në shumën e paguar prej 42,4 mil.euro. Numri i ndërmarrjeve të privatizuara deri në fund të vitit 2006 është rritur në 302. Prej tyre 16 ndërmarrje janë privatizuar me spinoff special. Janë nënshkruar 219 kontrata për ndërmarrje të vogla dhe 83 kontrata janë në proces e sipër të nënshkrimit. Të hyrat e përgjithshme nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore kanë arritur në 271 milion euro dhe 20% e tyre do t'i shpërndahet punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara²⁾.

Me qëllim të vuarjes së këtyre mjeteve në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit, Bordi i Agjensisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) ka miratuar vendimin për shpërndarjen e një pjese të mjeteve të Fondit të Privatizimit në depozitë bankave komerciale, sipas konkursit i cili do të publikohet në fillim të vitit 2007.

2.3. Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore në fund të vitit 2006 janë realizuar në shumën prej 713.2 milion euro dhe janë më të larta se në fund të vitit paraprak për 71.7 mil.euro, ose për 11.2 %. Niveli i të ardhurave të përgjithshme buxhetore varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të vendit.

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore, që nga viti 2003 janë realizuar kryesisht nga të hyrat vendore: dogana, TVSH, tatimi i paragjykuar, tatimi në fitim dhe taksat tjera. Në strukturën e të ardhurave buxhetore, të ardhurat nga dogana marrin pjesë me 64.1% në fund të vitit 2006 dhe janë më të larta se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak për 20.6 mil.euro, për shkak të impor-

tit të lartë.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në fund të vitit 2006 janë realizuar në shumën prej 635.7 mil.euro, përkatësisht më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar për 66.7 mil.euro. Rritja më e ulët e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore se të ardhurat e përgjithshme buxhetore ka rezultuar me suficitin e buxhetit në fund të vitit 2006 në shumën prej 77.5 mil.euro.

Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet³⁾

në mil.EURO

Përshkrimi/Periudha	2002	2003	2004	2005	2006
Të ardhurat e përgjithshme buxhetore nga taksat:	444.4	536.4	550.1	559.6	621.1
-dogana	364.5	428.3	436.0	436.5	457.1
-taksa tjera	79.9	108.1	114.1	123.1	164.0
Të ardhurat tjera	91.3	93.9	84.7	81.9	92.1
Gjithsej:	537.7	630.3	634.8	641.5	713.2
Shpenzimet e përgjithshme	428.6	567.7	769.4	702.4	635.7
Suficiti/deficiti	107.1	62.6	-134.6	-60.9	77.5

2.4. Inflacioni

Inflacioni, nëpërmës të çmimeve me pakicë, ka shënuar rritje të ulët që nga viti 2002, kur ka filluar të llogaritet inflacioni pas luftës së vitit 1999. Rritja më e lartë është shënuar në fund të vitit 2003 për 3,7%, ndërsa në fund të vitit 2005 është për 2,8% dhe në fund të vitit 2006 për 3.9 %⁴⁾.

Rritja e inflacionit ishte më tepër rezultat i inflacionit të importuar, për shkak të importit shumë të lartë të mallrave dhe shërbimeve.

2.5. Tregtia e jashtme

Gjatë vitit 2006 kanë vazhduar aktivitetet më të mëdha në import se në eksport të mallrave dhe shërbimeve⁵⁾.

Shuma e përgjithshme e importit prej 1.314.6 mil.euro në fund të vitit 2006 ishte më e lartë se në fund të vitit 2005 për 134.6 mil.euro, ose për 11.4%. Ndërsa, shuma e përgjithshme e eksportit në fund të vitit 2006, prej 79.2 mil.euro ishte më e lartë se në fund të vitit 2005 për 30.3 mil.euro, ose për 619%.

Për shkak të rritjes së eksportit në fund të vitit 2006, është rritur edhe mbulesa e importit me eksport nga 4,1% në fund të vitit 2005, në 6,0%, ndërsa deficiti i bilancit tregëtar nga

2) Autoriteti Qëndror Bankar i Kosovës: "Monthly Statistic Bulletin", nr.64/06

3) Autoriteti Qëndror Bankar i Kosovës: "Monthly Statistic Bulletin", janar/07, f.38

4) Autoriteti Qëndror Bankar i Kosovës: "Monthly Statistic Bulletin", janar/07, f.39

5) Burimi i njëjtë, f.44

1.131,1 mil.euro në 1.235.3 mil.euro.
Partnerët kryesor tregtar të importit në fund të vitit 2006 me 78,2% pjesëmarrje, janë:

· Unioni Europian	31,0%
· Maqedonia	20,0%
· Serbia	14.6%
· Turqia	6,8%
· Kina	5,8%

Partnerët kryesor tregtar të exportit me 74,8% pjesëmarrje janë:

· Unioni Europian	28,3%
· Shqipëria	13.2%
· Serbia	15.0%
· Maqedonia	10,3%
· Zvicra	8,0%

2.6.Papunësimi

Papunësia është në rritje të vazhdueshme që nga viti 2000 dhe në fund të vitit 2006 ka arritur në 326.026,që është më shumë për 56,4%⁶⁾.

Në rritjen e papunësisë ka ndikuar niveli i ulët i zhvillimit ekonomik.

Periudha	Numri i të papunëve	Femra%	Edukimi elementar %	Edukimi sekondar %	Edukimi universitar %
2002	257.505	44,5	61,5	36,2	2,2
2003	282.305	45,4	63,0	35,3	1,7
2004	301.982	45,7	63,4	35,1	1,5
2005	319.721	46,3	63,5	35,0	1,5
2006	326.026	46,7	63,7	34,8	1,5

Pjesëmarrja e femrave në numrin e përgjithshëm të papunësuarve është rritur nga 44,5% në vitin 2002,në 46,7% në fund të vitit 2006.Ndërsa,sipas kualifikimit shkollor,pjesëmarrje më të lartë ka shënuar edukimi elementar me 63,7%,kurse më të ulët edukimi univerzitar me 1,5% në fund të vitit 2006.

2.7.Sistemi bankar dhe financat

Sistemi bankar i Kosovës pas falimentimit të Bankës Kreditore,Prishtinë në shkurt të vitit 2006,përbëhet prej 6 bankave komerciale të nivelit të dytë dhe 220 degëve e nëndeg⁷⁾ në tërë territorin e Kosovës. Të gjitha bankat

komerciale selinë e kanë në Prishtinë,ndërsa degët e tyre janë të hapura në shtat qendra kryesore të Kosovës:Prishtinë,Mitrovicë,Pejë,Gjakovë,Prizren,Gjilan,Ferizaj.

Bankat me degët dhe nëndegët e tyre janë të licencuara nga Autoriteti Qendror Bakar i Kosovës,në mbështetje të Rregullores për Licencimin,Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave të vitit 1999.Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës vazhdon të jetë e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut deri në zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe nuk i ka të gjitha autorizimet e një banke qendrore.

Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale në

në 000 EUR

Përshkrimi/ Periudha	2002	2003	2004	2005	2006
Depozita	427.194	514.045	692.296	838.584	923.260
Kredi	86.498	232.773	373.668	492.079	576.912
% kredi/depozita	20,2	45,3	53,9	58,7	62,5
Fitimi neto	2.716	6.801	10.349	13.229	19.297

Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme⁸⁾ : Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2006 është më e lartë për 116,1% në krahasim me vitin 2002 dhe për 10% në krahasim me vitin 2005.Rritja e depozitave prej vitit në vit është rrjedhim i rritjes së besimit të klientëve(kursimtarëve) në bankat komerciale,si rezultat i likuiditetit të lartë dhe të qëndrueshëm bankar.

Depozitat e afatizuara në fund të vitit 2006 kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2004 dhe 2005, duke ndikuar në krijimin e kushteve

në 000 EUR

Depozita	2004	2005	2006
Llogari rrjedhëse	278.697	296.607	319.008
Depozita të afatizuara	413.599	541.977	604.252
Gjithsej:	692.296	838.584	923.260

për një politikë më të qëndrueshme kreditore: Për të ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit, bankat komerciale që nga viti 2003 e rritën përkrahjen financiare të aktiviteteve ekonomike nëpërmes të kred-

6)Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës:"Monthly Statistics Bulletin",janar/07,f.39

7)Burimi i njëjtë,

8) Shënimet e publikuara të bankave komerciale në gazetat e përditshme.

itimit të bizneseve të vogla, të mesme dhe personave individual (fizik) për destinime të ndryshme.

Pjesëmarrja e shumës së përgjithshme të kredive (portofolio neto) në shumën e depozitave është rritur nga 20.2% në fund të vitit 2002 në 62.5% në fund të vitit 2006. Ndërsa shuma e përgjithshme e kredive është rritur për 566.9% (mbi pesë herë) në fund të vitit 2006, në krahasim me vitin 2002 dhe për 17.2% në krahasim me vitin 2005.

Nëse krijohen kushtet për aplikimin e tërësishëm të Rregullores mbi hipotekën dhe pengun, bankat do të minimizojnë rrezikun nga kthimi me kohë i kredive dhe kanë mundësi të rrisin pjesëmarrjen e kredive në shumën e përgjithshme të depozitave deri në 70%.

Keqësimi i gjëndjes së përgjithshme ekonomike në vend ka ndikuar në rënien e aktiviteteve ekonomike dhe përkeqësimi i tillë i afarizmit ndikoi në kthimin jo më kohë të kredive duke rezultuar me rritjen e shpenzimeve për rezervime të kredive të dobëta, përkatësisht edhe në zvogëlimin e fitimit të bankave. Kredtë në fund të vitit 2006 janë shfrytëzuar me këtë strukturë brenda ekonomisë:

· tregti	371.178.000 euro	ose	64.3%
· industri	96.328.000 euro	ose	16.7%
· bujqësi	16.578.000 euro	ose	2.9%
· të tjera	92.828.000 euro	ose	16.1%

Gjithsej: 576.912.000 euro ose 100 %

Në kuadër të ekonomisë, bujqësia shfrytëzoi më së paku kredi edhe pse ka resurse për një zhvillim shumë më të lartë. Në zhvillimin më të lartë të bujqësisë mund të ndikohet me ndërmarrjen e masave stimulative: politika fiskale, kredi me afatë më të gjatë të shfrytëzimit dhe normë më të ulët të interesit, politika doganore, etj. Ndërsa, shfrytëzimi i ulët i kredive në industri rezultoi me mosinteresimin e investitorëve të huaj për shkak të mos zgjidhjes së Statusit të Kosovës, përkatësisht garan-

timit të investimeve.

Gjatë vitit 2006 është përmirësuar dukshëm struktura afatore e kredive për shkak të shfrytëzimit të linjave kreditore nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Fondi Europian për Europën Juglindore. Më së shumti u shfrytëzuan kreditë me afat mbi 24 muaj. Pati shfrytëzim të kredive me afat 5-7 vjet për biznese të vogla dhe të mesme, si edhe për persona fizik.

Rritja e afarizmit të bankave komerciale (niveli i kredive dhe shërbimet tjera) në vitin 2006 rezultoi me realizimin e fitimit neto në shumën prej 19.3 mil.euro. Vetëm një bankë realizoi humbje për shkak të rezervimeve të larta për kreditë e dobëta.

Mjetet e lira të depozitave, pas shfrytëzimit për kredi dhe sigurimin e likuiditetit minimal të bankave (10% nga shuma e depozitave), bankat komerciale i kanë plasuar në bankat korrespondente me normë më të ulët të interesit.

Kapitali financiar i pashfrytëzuar në fund të vitit 2006⁹⁾, ishte:

	në mil.euro
· llogaritë rrjedhëse	581.0
· depozitat në banka korrespondente	342.1
· Trusti i pensioneve	210.0
· Fondi i AKM-së	271.0
Gjithsej:	1.404.1
· Kredi bankare	576.9
Gjithsej:	827.2

Edhe gjatë vitit 2006 mjetet e lira të Trustit pensional dhe Fondit të AKM-së për privatizim të ndërmarrjeve shoqërore vazhduan të jenë jashtë sektorit bankar në Kosovë. Mirëpo, në vitin 2007 do të shfrytëzohet një pjesë e mjeteve të Fondit të AKM-së për zhvillimin ekonomik, përmes kredive bankare.

9) Autoriteti Qëndror Bankar i Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin", nëntor/06, nr.63.


3. Vështrim mbi afarizimin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2006

Banka Ekonomike në fund të vitit 2006 ka realizuar shumën e aktivës prej 50.7 mil.euro dhe shumën e përgjithshme të bilancit prej 54.2 mil.euro, duke përfshirë zërat jashtëbilansor. Në krahasim me vitin e kaluar, shuma e përgjithshme e aktivës ishte më e lartë për 11.2% dhe shuma e bilancit për 15.1%.

Fitimi i përgjithshëm neto për vitin 2006 ishte 630.395 euro dhe në krahasim me vitin e kaluar ishte më i lartë për 71.2%.

Norma e dividendës, duke vënë fitimin neto në raport me kapitalin aksionar në fund të vitit 2006, në shumën prej 4.725.031 euro, ishte 13.3%.

Ecuritë e realizuara afariste të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2006 (numri i llogarive të klientëve, depozitat dhe kreditë) ishin mbi ato të viti paraprak.




3.1 Numri i llogarive të klientëve

Numri i llogarive të klientëve të Bankës Ekonomike ka shënuar rritje të vazhdueshme prej viti në vit dhe në fund të vitit 2006 është rritur në 42.065, me këtë strukturë:

Përshkrimi Viti	2002	%	2003	%	2004	%	2005	%	2006	%
Persona juridik	1.042	7.6	1.660	8.6	2.466	8.9	3.085	9.1	3.644	8.7
Persona fizik	12.702	92.4	17.589	91.4	25.743	91.1	31.020	90.9	38.421	91.3
Gjithsej:	13.744	100	19.249	100	27.809	100	34.105	100	42.065	100

Numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve në fund të vitit 2006 është rritur për 23.3% në krahasim me vitin e kaluar dhe për 206.1% në krahasim me vitin 2002.



Llogaritë e klientëve të hapura në Bankën Ekonomike janë të personave juridik dhe individual, vendas dhe të huaj. Llogaritë e personave individual marrin pjesë me 91.3% në numrin e përgjithshëm të llogarive në fund të vitit 2006.

Në kuadër të llogarive të personave individual, 29.387 u përkasin llogarive për pagesën e pagave dhe të pensioneve.

Llogaritë e klientëve sipas degëve të Bankës, më së shumti u hapën në degën: Prishtinë(10.405), Gjakovë(9.168), Pejë(8.936), Prizren(5.674) dhe Mitrovicë(4.201). Ndërsa dega në Gjilan me 2.233 llogari dhe në Ferizaj me 1.448 llogari, marrin pjesë më 8.7% në numrin e përgjithshëm të llogarive të klientëve.

3.2 Depozitat

Banka Ekonomike në fund të vitit 2006 realizoi shumën e përgjithshme të depozitave prej 43.3 mil. euro, përkatësisht për 11.7% më shumë se në vitin e kaluar, më këtë strukturë:


në 000 EUR

Përshkrimi / viti	2002	%	2003	%	2004	%	2005	%	2006	%
Depozita me afat	5.934	45.5	12.778	59.3	21.414	68.5	27.695	71.4	29.748	68.7
Depozita pa afat	7.119	54.5	8.783	40.7	9.865	31.5	11.066	28.6	13.540	31.3
Gjithsej:	13.053	100	21.561	100	31.279	100	38.861	100	43.288	100

Rritja e pjesëmarrjes së depozitave me afat në shumën e përgjithshme të depozitave, prej vitit në vit, ka rezultuar me kthimin e besimit të kursimtarëve në Bankë dhe krijimin e kushteve për një politikë stabile kreditore. Ndërsa, rritja e shumës së përgjithshme të depozitave ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në shumën e përgjithshme të depozitave në nivel të bankave komerciale në Kosovë nga 4.1% në vitin 2003, në 4.5% në vitin 2004, në 4.6% në vitin 2005 dhe në 4.7% në fund të vitit 2006.

Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2006 ka patur këtë përbërje:

Përbërja e shumës së përgjithshme të depozitave në mil. Euro në fund të vitit 2006



3.3 Kreditimi

Shuma e përgjithshme e kredive në shfrytëzim prej 21.893 mijë euro në fund të vitit 2006, është rritur për 922 mijë euro, përkatësisht për 4.4% në krahasim me vitin 2005.

Që nga fillimi i punës së Bankës më 6 qershor 2001, e deri në fund të vitit 2006 janë lejuar 8.272 kredi në shumën e përgjithshme prej 133.006.822 euro, ndërsa janë në shfrytëzim 2.207 kredi në shumën prej 21.893.684 euro, me këtë strukturë:

në 000 EUR


Të lejuara						Në shfrytëzim më 31.12.2006					
Ndërmarrje		Pers.individual		Gjithsej		Ndërmarrje		Pers.individual		Gjithsej	
Nr	Shuma	Nr	Shuma	Nr	shuma	Nr	Shuma	Nr	Shuma	Nr	shuma
2.760	122.745	5.512	10.261	8.272	133.006	378	19.086	1.829	2.807	2.207	21.893

Kreditë kanë shënuar rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, duke u rritur prej shumës 5.8 mil.euro në vitin 2002, në 21.9 mil. euro në fund të vitit 2006:




Kreditë në fund të vitit 2006 më së shumti janë shfrytëzuar nga ndërmarrjet të ndryshëm me këtë strukturë:


a) Sipas destinimit :	Shuma €	Struktura
• 28 kredi për mjete themelore	1,150,946.45	5.26
• 350 kredi për mjete xhiruese	17,935,215.78	81.92
• 1829 kredi përsonave fizik	2,807,522.39	12.82
Gjithsej:	21,893,684.62	100,00 %



b) Sipas veprimtarive :	Shuma €	Struktura
• 22 kredi për prodhim	1,868,239.65	8.53
• 254 kredi për tregti	13,213,874.19	60.35
• 53 kredi për shërbime	2,096,867.31	9.58
• 3 kredi për transport	36,517.00	0.17
• 14 kredi për bujqësi	119,739.00	0.55
• 14 kredi për hoteleri	222,526.50	1.02
• 18 kredi për ndërtimtari	1,528,398.58	6.98
• 1829 kredi përsonave fizik	2,807,522.39	12.82
Gjithsej:	21,893,684.62	100,00%




c) Sipas Afatit :	Shuma €	Struktura
• 13 kredi deri 1 muaj	816,642.28	3.73
• 29 kredi 1 deri 6 muaj	235,196.89	1.07
• 434 kredi 6 deri 12 muaj	6,202,225.02	28.33
• 337 kredi 12 deri 18 muaj	503,841.34	2.30
• 1261 kredi 18 deri 24 muaj	8,220,770.47	37.55
• 133 kredi 24 deri 36 muaj	5,915,008.62	27.02
Gjithsej:	21,893,684.62	100,00%



d) Sipas pronësisë :	Shuma €	Struktura
• 0 kredi ndërmarrjeve shoqërore	0.00	0.00
• 378 kredi ndërmarrjeve Private	19,086,162.23	87.18
• 1829 kredi personave Fizik	2,807,522.39	12.82
Gjithsej:	21,893,684.62	100,00%



e) Sipas Filialave :	I (kredit)		II (garancionet)		Gjithsej: I+II	
	Shuma €	Struk.	Shuma €	Shuma €	Struk.	
• 648 Prishtinë	8,215,149.91	37.52	724,935.07	8,940,084.98	38.99	
• 389 Gjakovë	4,688,817.72	21.42	174,388.85	4,863,206.57	21.21	
• 437 Pejë	4,397,818.25	20.09	27,000.00	4,424,818.25	19.30	
• 189 Prizren	1,860,373.92	8.50	95,290.00	1,955,663.92	8.53	
• 230 Mitrovicë	1,176,138.39	5.37		1,176,138.39	5.13	
• 150 Gjilan	909,494.40	4.15		909,494.40	3.97	
• 164 Ferizaj	645,892.03	2.95	13,200.00	659,092.03	2.87	
Gjithsej:	21,893,684.62	100,00%	1,034,813.92	22,928,498.54	100,00%	



Për shkak të vështirësimit të kushteve të afarizmit, që nga viti 2003, disa huamarrësve iu është keqësuar gjëndja materiale - financiare dhe filluan të mos i paguanjnë anuitetet e kredive më kohë dhe Banka u detyrua të ngreh padi gjyqësore në bazë të hipotekës në pasurinë e paluajtshme, e më pak në bazë të pengut. Deri në fund të vitit 2006 janë paditur 132 huamarrës në shumën prej 1.467.091 euro. Këto lëndë gjyqësore gjinden në faza të ndryshme të procedurës. Deri më tani janë arkëtuar 408.755 euro, përkatësisht 27.9% të shumës së paditur.

3.4 Qarkullimi i pagesave

Qarkullimi i pagesave gjatë vitit 2006 është kryer përmes Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës (kliringu) dhe bankave korrespondente (transferta e mjeteve nga jashtë dhe jashtë vendit).

a) Qarkullimi i pagesave të brendëshme midis klientëve të bankave komerciale përmes AQBK-së (kliringu), është në rritje të vazhdueshme prej vitit në vit dhe në fund të vitit 2006 ka arritur shumën prej 151.4 mil. euro dhe për 10.8% është më i lartë se në vitin e kaluar. Nga kjo shumë, 62.8 mil.euro janë realizuar përmes transfertës hyrëse të mjeteve për 18.117 transaksioneve. Ndërsa, pjesa tjetër e shumës prej 88.6 mil.euro është realizuar përmes transfertës dalëse të mjeteve për 17.032 transaksione. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në shumën e përgjithshme të transaksioneve bankare përmes AQBK në fund të vitit 2006 është realizuar më 6.5%, ndërsa në numrin e përgjithshëm të transaksioneve më 3.5%.

b) Qarkullimi i pagesave me botën (transferta e mjeteve nga jashtë dhe jashtë vendit) në vitin 2006 është realizuar në shumën prej 125.7 mil.euro dhe për 17.0% më shumë se në vitin e kaluar, nëpërmes të tri bankave korrespondente:

- LHB Internacionale Handelsbank, Frankfurt, Gjermani;
- RZB Raiffeisen Zentralbank Oestereich AG, Vjenë, Austri;
- BASH Banka Amerikane e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri;

Transferta e mjeteve jashtë vendit bëhet në mënyrë të shpejtë me anë të bartjes elektronike (LHB, RZB me internet, BASH bartje automatike me sistemin ON-LINE).

Transferta e mjeteve në kuadër të shteteve europiane është kryer brenda 24 orëve, kurse për shtetet jashtë Evropës brenda 48 orëve. Transferta e mjeteve nëpërmes të BASH bëhet menjëherë brenda disa minutave për klientët e të dy bankave.

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në shumën e përgjithshme të transfertës hyrëse të mjeteve në nivel të bankave komerciale në Kosovë, në fund të vitit 2006 është realizuar më 4.3%, ndërsa e transfertës dalëse të mjeteve më 3.7%.

c) Banka ka të instaluar sistemin ON-LINE me të gjitha degët që mundëson kryerjen e menjëherëshme të shërbimeve të klientëve, pavarësisht se në cilën degë të Bankës e kanë të hapur llogarinë bankare.

Qarkullimi i pagesave në llogarinë e klientit dhe midis klientëve në tërë rrejetin e degëve të Bankës bëhet gratis. Banka i stimulon klientët për shërbimet e transfertës së mjeteve në valuta tjera jashtë vendit pa kompensim për konvertim të euros në valuta tjera.

3.5. Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme në fund të vitit 2006 janë realizuar në shumën prej

4.9 mil.euro, përkatësisht për 7.6% më shumë se në vitin e kaluar. Pjesëmarrjen më të lartë në shumën e të ardhurave të përgjithshme e kanë:

› të ardhurat nga interesi në kreditë e dhëna	56.2%
› të ardhurat nga komisionet për kreditë e dhëna	7.5%
› të ardhurat nga komisionet për transfertën e mjeteve jashtë vendit, garancione dhe L/K	8.1%
› të ardhurat nga interesi për mjetet e lira ditore në bankat korrespondente	7.9%
› të tjera	20.3%

Të ardhurat nga interesat në kreditë e dhëna, së bashku me të ardhurat nga bankat korrespondente dhe AQBK-ja janë realizuar në shumën prej 3.201 mijë euro. Në krahasim me vitin e kaluar janë rritur për 6.2%. Nëse këto të ardhura i zvogëlojmë për shpenzimet e interesave në depozita me afat, në shumën prej 1.094 mijë euro, atëherë të ardhurat neto nga interesat janë realizuar në shumën prej 2.107 mijë euro dhe në krahasim me vitin e kaluar janë zvogëluar për 4.6%, për shkak të rritjes së normës së interesit në depozita të afatizuara dhe ulëjes së normës në kreditë për destinime të personave individual.

Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në shumën prej 4.3 mil.euro në fund të vitit 2006 dhe janë rritur për vetëm 2.1% në krahasim me vitin e kaluar. Pjesëmarrjen më të lartë në shumën e shpenzimeve të përgjithshme në fund të vitit 2006, e kanë:

› shpenzimet për të ardhurat personale	28.6%
› shpenzimet e interesit në depozita me afat	25.4%
› shpenzimet e qirasë	9.3%

› shpenzimet e rezervave për kredi në shfrytëzim	6.8%
› shpenzimet e amortizimit të mjeteve themelore	6.7%
› shpenzimet e tatimit në fitim	3.7%
› të tjera	19.5%

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme në shumën më të ulët se të ardhurat e përgjithshme rezulton me realizimin e fitimit neto në shumën prej 630.395 euro në fund të vitit 2006, që është më i lartë se në vitin e kaluar për 71.2%.

Banka Ekonomike në fund të vitit 2006 ka realizuar këta:

Tregues kryesor

› Raporti i fitimit neto mbi aktivën (ROA)	1.2%
› Raporti fitimit neto mbi aktivën me risk (RORA)	2.1%
› Raporti i fitimit neto mbi kapitalin në fund të vitit (ROE)	9.5%
› Raporti i fitimit neto mbi kapitalin aksionar në fund të vitit	13.3%
› Raporti i kapitalit (klasa I) mbi aktivet	13.1%
› Shpenzimet e përgjithshme në raport me të ardhurat e përgjithshme	87.2%

3.6 Zgjerimi dhe modernizimi

Banka Ekonomike që nga linçensimi dhe rifillimi i punës në qershor të vitit 2001 e deri në fund të vitit 2006 ka hapur 7 degë, 2 nëndegë dhe 21 zyra në tërë Kosovën.

Degët janë hapur në shtatë qendra kryesore të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Ndërsa, ekspoziturat janë të hapura në Istog (Burim) dhe Rahovec, kurse zyrat në tërë territorin e Kosovës, kryesisht në pikat doganore dhe regjistrimit të automjeteve.

Me zgjerimin e rrjetit të Bankës janë krijuar

kushtet për rritjen e shërbimeve: depozita, kredi për persona juridik e individual, qarkullimi i pagesave në vend (kliringu) dhe me botën e jashtme, shërbime të ndryshme bankare, duke rritur pjesëmarrjen në tregun bankar.

Gjatë vitit 2006 është realizuar Projekti për blerjen, montimin dhe funksionimin e sistemit të bankomateve (10) me POS terminale (22) në tërë rrjetin e degëve të Bankës. Është lansuar me sukses kartela për tërheqje të parave nga bankomatet (BEX CARD).

Që nga viti 2004 klientët e Bankës Ekonomike në bashkëpunim me Bankën Amerikane të Shqipërisë janë duke përdorur kartelën American Express. Në janar të vitit 2007 është lansuar produkti i ri i Bankës Ekonomike: leximi i gjendjes së llogarisë bankare përmes mesazhit SMS.

Këshilli drejtues

Bardhyl Minxhozi	Kryetar
Ali Buza	zëv.kryetar
Hasan Hajdari	anëtar
Raif Rexhepi	anëtar
Xhabir Kajtazi	anëtar
Qerim Ramadani	anëtar
Gazmend Tuzi	anëtar
Ismet Gjoshi	anëtar
Hajrullah Zaiti	anëtar

Drejtor i përgjithshëm i Bankës

Drejtuesit

Hajrullah Zaiti	Drejtor i përgjithshëm
Mazllom Beqa	Zëvendës drejtor i përgjithshëm
Arbnor Pajaziti	Ndihmës drejtor i përgjithshëm për IT
Syzane Kaçaniku	Ndihmës drejtore e përgjithshme dhe Drejtore e Drejtorisë financiare
Naim Kastrati	Drejtor i Drejtorisë së kreditimit
Xhelal Kusari	Drejtor i Drejtorisë për punë juridike dhe të përgjithshme
Enver Vula	Shef i revizionit të brëndshëm
Teki Ukmata	Drejtor, Dega Prishtinë
Nuriye Haxhikadrija	Drejtor, Dega Gjakovë
Izet Mahmuti	Drejtor, Dega Pejë
Hysein Kendos	Drejtor, Dega Prizren
Eset Shaqiri	Drejtor, Dega Mitrovicë
Nazmi Dushi	Drejtor, Dega Ferizaj
Naser Muji	Drejtor, Dega Gjilan

Bankat Korrespondente

LHB Internationale Handelsbank, Frankfurt, Gjermani

ABA Amerikan Bank of Albania, Tiranë, Shqipëri

RZB Raiffeisen Zentral Bank Oesterreich, Vjenë, Austri



Ky perktim eshte vetem per qellime informimi. Varianti anglisht qe eshte edhe origjinali ka prioritet mbi te.

Raporti i Audituesve të Pavarur

Pronarëve të Bankës
Banka Ekonomike Sh.a. Prishtinë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Banka Ekonomike Sh.a. ("Banka"), që përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2006, dhe pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël e shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale, që mund të jenë pasojë e gabimeve apo mashtrimit; zgjedhjen dhe përdorimin e politikave kontabël të duhura; dhe bërjen e çmuarjeve kontabël të cilat janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Me përjashtim sa trajtohet në paragrafët 1 deri në 3 Baza për Opinion me Rezervë, ne e kryem auditimin tonë në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme, dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

Baza për Opinion me rezervë

- 1 Siç përshkruhet në Shënimin 4 mbi pasqyrat financiare, Banka e ka llogaritur rënien në vlerë për Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve më 31 Dhjetor 2006 dhe 31 Dhjetor 2005 me një metodë, e cila sipas nesh nuk është në përputhje me SNK 39 “Instrumente Financiare: Njohja dhe Matja”. Raporti ynë mbi pasqyrat financiare për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005 është modifikuar për këtë. Ne mungesë të një alternative të përshtatshme llogaritje nga Banka të shumave të rikuperueshme të huave dhënë klientëve, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën e akumuluar të humbjeve nga rënia në vlerë e huave dhëne klientëve, fitimin e pashpërndarë më 31 Dhjetor 2006 dhe 31 Dhjetor 2005 dhe humbjen nga rënia në vlerë e huave për ushtrimet e mbyllur në këto data.
- 2 Siç përshkruhet në Shënimin 3 (c), Banka i njej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet prej aktivitetit kreditor të bankës, kur arkëtohen paratë. Këto tarifa e komisione në shumën prej EUR 371 mijë për ushtrimin e mbyllur 31 Dhjetor 2006 (2005: EUR 408 mijë) lidhen me dhëniet e kredive, dhe në përputhje me Standartin 18 “Të ardhurat”, dhe së bashku me kostot direkte të lidhura me to duhet te shtyhen dhe njihen si një rregullim në normën efektive të interesit për instrumentin e lidhur me të. Si rezultat i sa më sipër, dhe në mungesë të llogaritjeve të përshtatshme nga Banka, të shumës së këtyre komisioneve që duhen shtyrë në periudhat e ardhshme, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën me të cilën, kreditë e dhëna klientëve, më 31 Dhjetor 2006 dhe 31 Dhjetor 2005 dhe të ardhurat nga tarifat dhe komisionet për ushtrimet e mbyllura në këto data janë mbiçmuar.
- 3 Në shpenzimet e tjera operationale përfshihen shpenzimet për keqpërdorim të mjeteve të cilat lidhen me keqpërdorimet e parave të gatshme në vlerë prej 156 mijë EUR dhe zbuluar më 9 Dhjetor 2006. Banka ka arkëtuar 21 mijë EUR në muajt në vijim nga ish drejtori i deges se Gjilanit, por nuk e ka pakësuar humbjen për shumën e marrë. Banka është e siguruar nga një policë BBB e Kompanisë së sigurimeve “Siguria” (palë e lidhur). Banka ka raportuar dëmin prej 134 mijë EUR në kompaninë e sigurimeve dhe gjithashtu ka ngritur aktpadi kundër ish punonjësve. Humbja nuk është rregulluar për vlerësimin e Drejtimit për shumën që pritet të arkëtohet nga pagesa e dëmit të sigurimit. Rezultatet e procesit që është në vazhdim e sipër nuk mund të përcaktohen ende, dhe për pasojë ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën me të cilën mund te duhet te regulloheshin shumat e treguara në pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2006 për llogaritë e arkëtueshme, shpenzime të tjera operationale, fitimin neto, dhe fitimet e pashpërndara.

Opinion me rezervë

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të rregullimeve, në qoftë se do të kishte ndonjë të tillë, që mund të ishin përcaktuar të nevojshme nëse do të ishte e mundur të përcaktohej efekti i tyre, për sa trajtohet në paragrafët 1 deri në 3 të Bazës për Opinion me Rezervë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të Bankës më datë 31 Dhjetor 2006 dhe për rezultatet e veprimtarive të saj, dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Sh.p.k.

27 Prill 2007
Prishtinë

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

<i>Në EUR '000</i>	Shenime	2,006	2,005
Të ardhurat nga interesat		3,437	3,084
Shpenzimet për interesat		(1,094)	(805)
Të ardhurat neto nga interesat	5	2,343	2,279
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	6	1,429	1,353
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet		(88)	(74)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet		1,341	1,279
Të ardhura të tjera operacionale	7	134	116
Rezultati neto nga këmbimet valutore		(63)	34
Te ardhurat operacionale		3,755	3,708
Humbje nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve	13	(293)	(1,181)
Shpenzime të tjera operacionale	8	(2,673)	(2,067)
Shpenzimet operacionale		(2,966)	(3,248)
Fitimi para tatimit		789	460
Tatimi mbi fitimin	9	(158)	(92)
Fitimi neto i periudhës		631	368

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 23 deri në faqen 51 janë pjesë përbërëse e pasqyrave.

Keto pasqyra financiare si ne faqet nga 21 deri në faqen 49 u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të Bankës më 23 Prill 2007 dhe u nënshkruan nga përfaqësuesit si më poshtë:

Hajrullah Zaiti
Drejtör Ekzekutiv

Syzane Kaçaniku
Drejtore e Drejtorisë së Financave

Bilanci Kontabël më 31 Dhjetor

Në EUR '000	Shenime	2006	2005
Aktiva			
Para ne arkë dhe në banka	10	23,297	16,344
Llogaritë e bllokuara me Bankën Qëndrore	11	4,329	3,636
Hua dhe paradhënie institucioneve bankave	12	322	2,811
Hua dhe paradhënie klientëve	13	21,136	21,171
Investimet në prona	14	443	-
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	15	1,021	1,139
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	16	108	140
Aktive të tjera		64	59
Totali i aktiveve		50,720	45,300
Detyrimet			
Hua dhe paradhënie nga bankat	17	-	2,503
Detyrime ndaj klientëve	18	43,913	36,637
Tatim i pagueshëm	9	82	28
Detyrime të tjera	19	105	143
Totali i detyrimeve		44,100	39,311
Kapitali i aksionerëve			
Kapitali aksioner	20	4,725	4,725
Rezerva e përgjithshme	20	102	102
Fitimi i pashpërndarë		1,793	1,162
Totali i kapitalit të aksionerëve		6,620	5,989
Totali i detyrimeve dhe i kapitalit të aksionerëve		50,720	45,300

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 23 deri në faqen 51 janë pjesë përbërëse e pasqyrave.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

Në EUR '000					
	Shëni- me	Kapitali aksioner	Rezerva e përgjithshme	Fitimi i pashpërnd arë	Totali
Më 1 Janar 2005		4,725	102	794	5,621
Fitimi neto i periudhës		-	-	368	368
Më 31 Dhjetor 2005		4,725	102	1,162	5,989
Fitimi neto i periudhës		-	-	631	631
Më 31 Dhjetor 2006	20	4,725	102	1,793	6,620

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 23 deri në faqen 51 janë pjesë përbërëse e pasqyrave.

Pasqyra e fluksit të parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

Ne EUR '000	Shenime	2,006	2,005
Fluksi i parasë nga aktivitetet operacionale			
Fitimi para tatimit		789	460
Korigjime për të barazuar fitimin me fluksin neto nga aktivitetet operacionale:			
Zhvlerësimi	14,15	248	179
Amortizimi	16	38	28
Humbje nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve	13	293	1,181
Marrja ne pronesi e kolateraleve te kredive	14	(460)	-
Humbje nga nxjerrja nga përdorimi i mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara		6	1
Të ardhurat nga interesat	5	(3,437)	(3,084)
Shpenzimet për interesat	5	1,094	805
		(1,429)	(430)
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operacionale:			
Rritje në llogaritë me Bankën Qëndrore		(693)	(733)
Ulje në hua dhe paradhënie bankave		2,485	-
Ulje (Rritje) në hua dhe paradhënie klientëve		(210)	(5,670)
Rritje (ulje) në aktive të tjera		(5)	38
Ulje në hua dhe paradhënie nga bankat		(2,500)	-
Rritje në detyrimet ndaj klientëve		7,027	7,482
Rritje (ulje) në detyrimet e tjera		(38)	79
Tatimi mbi fitimin i paguar	9	(104)	(120)
Interesi i arketuar		3,393	3,003
Interesi i paguar		(848)	(694)
Fluksi neto nga aktivitetet operacionale		7,078	2,955
Fluksi i mjeteve monetare për aktivitet investuese			
Blerja e mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara	15	(119)	(757)
Blerja e mjeteve të qëndrueshme të patrupëzuara	16	(6)	(10)
Fluksi neto për aktivitetet investuese		(125)	(767)
Rritje/(ulje) neto në para dhe ekuivalentet e saj			
Paraja dhe ekuivalentet e saj, në fillim të vitit		16,344	14,156
Paraja dhe ekuivalentet e saj, në fund të vitit	10	23,297	16,344

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 23 deri në faqen 51 janë pjesë përbërëse e pasqyrave.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

1. Të përgjithshme

Në përputhje me rregulloren e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës ("BPK"), Banka Ekomike Sh.a. Prishtinë ("Banka") mori licensën për zhvillimin e aktivitetit bankar më 28 Maj 2001 dhe filloi të operacionet e saj më 5 Qershor 2001. Zyrat qendrore të Bankës ndodhen në Rr. Migjeni Nr. 1, Prishtinë, Kosovo. Banka operon njëkohesisht si bankë tregtare dhe kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve, nëpërmjet rrjetit të saj prej 7 degësh të shtrira në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Më 31 Dhjetor 2006 Kapitali aksioner i Bankës është i ndarë në 18,457 aksione të zakonshme me vlerë EUR 256 secila, gjithsej EUR 4,725,031 (2005: EUR 4,725,031).

2. Bazat për përgatitjen e pasqyrave financiare

(a) Përputhshmëria me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF")

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë ndërtuar sipas parimit të kostos historike përveç sa vijon:

- Instrumente financiare me vlerë reale nëpërmjet pasqyrës së rezultatit që maten me vlerë reale dhe
- Aktiva financiare të vlefshme për shitje që maten me vlerë reale.

(c) Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë prezantuar në mijë EUR, që është gjithashtu dhe monedha funksionale e Bankës. Përveç kur shprehet ndryshe këto pasqyra shprehen në mijë EUR të rumbullakuara me përafërsi.

(d) Përdorimi i gjykimeve dhe supozimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtuesit e Bankës të gjykojnë, të vlerësojnë dhe të bëjnë supozime që kanë ndikim në zbatimin e politikave dhe në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto përllogaritje.

Përllogaritjet dhe supozimet e ndërlidhura rishihen herë pas here. Rishikimi i përllogaritjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën përllogaritja rishihet, nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat pasardhëse nëse rishikimi ndikon si në periudhën aktuale ashtu dhe në ato pasardhëse.

Në vecanti informatat më të hollësishme për përllogaritjet, supozimet dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël përshkruhen në shenimin nr. 4.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vijueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit valuator në datën e kryejës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare që mbahen në monedhe të ndryshme nga ajo e prezantimit të pasqyrave konvertohen në EUR me kursin në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Diferencat nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të ndryshme nga ajo e prezantimit të pasqyrave financiare, konvertohen me kursin në datën e transaksionit. Ndërsa aktivitet dhe detyrimet jo monetare në mon-

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

edhë të ndryshme nga EUR, që maten me vlerë reale konvertohen me kursin e dates së përcaktimit të vlerës reale. Diferencat nga kurset gjate rikonvertimit njhen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(b) Interesi

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interes njihen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur fitohen dhe nuk llogariten me normen efektive te interesit (Shih Shënimin (c)).

Shpenzimet e interesit qe janë prezentuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin mbi detyrimet me kosto të amortizimit si dhe normë efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht e zvogëlon vlerën e pritshme të pagesave dhe të hyrave në para të gatshme gjatë jetës së një aktive apo detyrimi financiar (ose, për një periudhe më të shkrutër kohore) në vlerën kontabel të asaj aktive apo detyrimi financiar. Norma efektive e interesit caktohet me njohjen fillestare të aktivës dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet pas-taj.

(c) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifrat dhe komisionet prej aktivitetit kreditor të bankës që janë integruar në normën efektive të interesit të pasurisë financiare nuk përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Keto të ardhura njihen kur arketohen parate.

Të ardhurat nga tarifrat dhe komisionet tjera që përfshijnë tarifrat për shërbimet e llogarive, komisionet e shitjes, tarifrat për plasmanet njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur sherbimi perfundon. Shpenzimet per tarifrat dhe komisionet e tjera lidhen kryesisht me transaksione dhe sherbime qe njihen kur shpenzimi pranohet.

(d) Pagesat për qeranë operative

Pagesat e bëra për qeranë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qerasë. Cdo e mire nga qeraja shpendahet gjate gjithë periudhes se kontrates si pjese perberese e shpenzimit.

(e) Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operative njihen në momentin kur ato ndodhin.

(f) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kontributeve minimale për pensionet në Kososvë në kuadër të një plani të mirëpërcaktuar. Kontributet për sigurimet shoqërore njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ato ndodhin.

(g) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin apo humbjen e vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç se kur lidhet me elementë që njihen direkt në Kapital. Në këtë rast edhe tatimi njihet në Kapital.

Tatimi aktual është tatimi për t'u paguar tek organet tatimore, i përlogaritur me normën tatimore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare si dhe duke përfshirë ndonjë korigjim të mundshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është rrjedhojë e diferencave të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për raportim financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi. Shuma e tatimit të shtyrë bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve duke përdorur normën e tatimit në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

Shuma e shtyre e taksave bazohet në realizimin apo shlyerjen e pritshme të vlerës kontabel të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat në fuqi të taksave.

Tatimi i shtyrë në aktiv njihet vetëm në rastin kur pritet të shkaktojë përfitime të tatueshme në të ardhmen si rrjedhojë e përdorimit të aktivitetit. Taksat e shtyra në aktive pakesohen në masën që benefiti prej tyre nuk është me i pritshëm të realizohet.

Tatime shtesë të lidhura me shpërndarjen e dividendëve njihen në të njëjtën kohë si detyrim në momentin që njihet detyrimi për pagesën e dividendët.

(h) Aktivitet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Huatë, paradhëniet dhe depozitat njihen në momentin e origjines. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare fillimisht njihen në ditën e tregtimit kur Banka bëhet palë në detyrimet kontraktuale.

(ii) Nxjerrja nga bilanci

Një aktiv financiar nxirret nga bilanci kur Banka nuk posedon më të drejta kontraktuale mbi atë fenomenin që përbën aktivin ose i transferon të drejtat kontraktuale për të pranuar para në të ardhmen në një transaksion që transferon të gjitha reziqet dhe të mirat e pronësive lidhur me aktivin financiar. Cdo interes në aktivet financiare të transferuara që është krijuar ose mbajtur nga Banka, njihet si aktiv apo detyrim i vecantë.

Banka nxjerr jashtë bilancit detyrimet financiare atëherë kur detyrimet kontraktuale përfundojnë, përmbushen apo mbyllen.

Banka gjithashtu e nxjerr jashtë bilancit aktivin e caktuar kur ky i fundit pritet të jetë i pambledhshëm. (Shënimi nr. 4).

(iii) Matja e kostos së amortizimit

Kosto e amortizimit të një aktiv apo detyrimi financiar paraqet shumën me të cilën aktivin apo detyrimin financiar maten në njo-

hjen fillestare duke ju zbritur pagesat e principalit si dhe duke ju shtuar respektivisht zvogëluar amortizimi i akumuluar përmes metodës lineare.

(iv) Matja e vlerës së tregut

Matja e vlerës së tregut bëhet duke përdorur teknikat e vlerësimit që përfshijnë teknikën e vlerës net të tregut, metodën e flukseve të ardhshme të parasë, krahasimin me instrumentet e ngjashme për të cilat ekziston çmimi i tregut si dhe modelet e vlerësimit. Banka përdor shumë modelet e vlerësimit për caktimin e vlerës së tregut të instrumenteve financiare si të thjeshta. Për këto variablat e përdorura në modele janë të vrojtueshme në treg.

(v) Identifikimi dhe matja e humbjes nga rënia e vlerës

Në çdo datë bilanci Banka përcakton nëse ka dëshmi që aktivet financiare kanë humbje nga rënia e vlerës së tyre. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në rast se vlera kontabel e një aktiv apo vlera e flukseve që do të gjenerojë është më e madhe se vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbje nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për një aktiv që nuk gjeneron fluks para të pavarur, shuma e rikuperueshme vendoset për njësinë që gjeneron para dhe të cilës aktiviteti i përket.

Shuma e rikuperueshme e huave dhe paradhënive me kosto të amortizuara është llogaritur si vlera e tanishme e flukseve të ardhshme të parasë, e aktualizuar me normën origjinale efektive të interesit (psh interesi efektiv në momentin e njohjes së këtyre instrumenteve financiare).

Një humbje nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënive të mbajtura me kosto të amortizuara, kthehet nëse rritja e mëpasshme në vlerën e rikuperueshme të aktivitetit është në mënyrë objektive e lidhur me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur.

Humbjet nga rënia e vlerës në aktive janë matur si në shënimin nr. 4. Humbjet janë

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur një ngjarje e mevonshme shkakton uljen në humbjen e matur, kjo humbje rrimeret në të ardhura.

(vi) Përcaktimi me vlerë reale nëpërmjet pasqyrës së rezultatit

Banka ka përcaktuar aktive dhe pasive me vlerë reale nëpërmjet pasqyrës së rezultatit kur njëri nga kushtet plotësohet:

- Aktivitet dhe pasivitet manaxhohen, vlerësohen dhe raportohen për qëllime të brendshme me vlerë reale;
- Përcaktimi eliminon ose pakëson konsiderueshëm mosperputhjen kontabël që do të ndodhte në të kundërt; ose
- Aktivitet ose pasivitet përmban një derivat të brendshëm që konsiderueshëm modifikon flukse të arkës që do të kerokoheshin në të kundërt sipas kontratës.

(i) Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përbëhet nga paratë në arkë dhe banka, balanca me Banken Qendrore si dhe nga depozitimet me maturitet nën tre muaj që nuk kanë rrezik për ndryshim të vlerës së tregut dhe përdoren prej Bankes për kryerjen e transaksioneve të përditshme.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen në bilancin e gjendjes me koston e amortizuar.

(j) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet paraqesin aktivitet financiar jo-derivat që nuk caktohen në treg aktiv si dhe banka nuk ka për qëllim t'i shese në një periudhë të shkurtër kohore.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë reale duke ju shtuar kosto direkte e transaksionit. Banka nuk i llogarite huatë dhe paradhëniet me metoden efektive të interesit.

(k) Investimet në prona

Investimet në prona mbahen për të marre

teardhura nga qeraja e tyre ose për rritje të vlerës së tyre në të ardhmen, apo për të dyja keto. Pronat janë fituar nepërmjet ekzekutimit të kolateralit të kredive mbi to. Pas njohjes fillestare Banka ka zgjedhur modelin e koston se amortizueshme. Ajo mat vlerën në përputhje me kerkesat e SNK 16.

Pronat e blera nga Banka njihen me koston (që për kolateralet është vlera e tyre e tregut) minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave në baza lineare dhe në jetën e përafert të vlefshme të aktivitetit. Jeta sipas vlerësimit të bankes është 20 vjet.

(l) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me koston minus rezervën për zhvlerësimin e akumuluar si dhe humbjet e mundshme nga rënia në vlerë.

(ii) Kosto të mevonshme

Shpenzimet që ndodhin për zëvendësimin e një komponenti të aktivitetit të regjistruar vecant kapitalizohen. Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivitetin. Çdo shpenzim tjetër regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën që ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi përaktivitetin dhe/ose pjesë të tij regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën zbritese gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar. Përmirësimet e objekteve me qera lidhen me lidhen me shpenzime të kryera mbi objektet e marra me qera dhe amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër midis jetëgjatësisë efektive të tyre dhe periudhës kontraktuale të qerasë. Jetëgjatësitë efektive për kategori të caktuara vijojnë si më poshtë:

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

- Përmirësimet e objekteve me qera 5 vjet
- Pajisje kompjuterike dhe të tjera 5 vjet
- Automjete 5 vjet
- Furnitura dhe pajisje 5 vjet

Metodat e zhvleresimit, jeta e aktiveve dhe vlerat e metura rishikohen çdo date raportimi.

(m) Aktivitet e qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivitet e qëndrueshme të patrupëzuara paraqiten me kosto minus rezervën për amortizimin e akumuluar si dhe humbjet e mundshme nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohet vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin. Çdo shpenzim tjetër regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën që ndodhin.

Amortizimi për aktivin dhe/ose pjesë të tij regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën zbritese gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar. Jetëgjatësitë e vlerësuar për programet kompjuterike është 5 vjet.

(n) Humbjet nga rënia në vlerë e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të Bankës, përveç tatimit të shtyrë rishikohet në çdo moment raportimi për të korigjuar ndonjë rënie në vlerë. Në rast se evidentohet mundësi për rënie në vlerë, atëherë ripërcaktohet shuma e rikuperushme e aktivitet.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen në rast se vlera kontabël e një aktivi apo vlera e flukseve që do të gjenerojë është më e madhe se vlera e rikuperushme e aktivitet. Humbje nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për një aktive që nuk gjeneron fluks paraqe te pavarur, shuma e rikuperushme ven-

doset për njesinë që gjeneron para dhe të cilës aktivi i përket.

Shuma e rikuperushme e huave dhe paradhenieve me kosto të amortizuara është llogaritur si vlera e tanishme e flukseve të ardhshme të parase, e aktualizuar me normen origjinale efektive të interesit (psh interesi efektiv në momentin e njohjes së ketyre instrumenteve financiare).

Një humbje nga rënia në vlerë e huave dhe paradhenieve të mbajtura me kosto të amortizuara, kthehet nëse rritja e mëpasshme në vlerën e rikuperushme të aktivitet është në mënyrë objektive e lidhur me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur.

Lidhur me aktivitet e trupezuara dhe të patrupëzuara, humbja kthehet nëse ka një ndryshim në vleresimet e perdorura në vendosjen e vlerës së rikuperushme. Një humbje nga rënia në vlerë kthehet vetëm në masën që vlera e aktivitet nuk kalon vlerën kontabel që do të ishte paraqitur si neto nga zhvleresimi apo amortizimi, nëse nuk do të do të ishte njohur ndonjë humbje.

(o) Depozitat dhe detyrimet tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet tjera janë burimet e financimit për bankën.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten me vlerë reale duke ju shtuar kostot e transaksionit si dhe në vazhdim maten me nomre efektive të interesit. Kjo nuk ndodh në rast se banka zgjedh që të mbaje detyrimin me vlerë të tregut përmes humbjes dhe fitimit.

(p) Provigjionet

Një provigjion njihet kur paraqet një detyrim ligjor apo konstruktiv për Bankën, mund të matet me besueshmeri, si dhe pritet që në të ardhmen të ketë dalje të mjeteve të Bankës për të përmbushur detyrimin. Provigjionet përcaktohen duke zvogeluar fluksin e pritshëm me norme që reflekton vleresimin e tregut si dhe kur

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

eshte e nevojshme risqet specifike per detyrimin.

(q) Standardet the interpretimet e reja qe nuk jane aplikuar

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, Interpretimet e Standarteve te reja të mëposhtme dhe amendimet të Standarteve ishin lëshuar por jo efektive dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare:

SNRF 7 Mjetet financiare: Informacione të publikuara. Standartet do të kërkojnë informacione të publikuara shtese në lidhje me mjetet financiare të Bankës. Ai zëvendëson informacionet e publikuara (SNK 30) në pasqyrat financiare të Bankës dhe Institucione Financiare të ngjashme dhe i aplikohet te gjitha Shoqerive që përgatisin pasqyrat financiare në përputhje me SNRF. Banka konsideron qe informacionet e publikuara shtesë te kërkuara do të lidhen me rrezikun financiar të objektivave drejtues, politikave dhe proceseve.

KIFRN 7 Aplikimi i Rivendosjes sipas SNK 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacionare. Interpretimi përmban drejtim se si një Shoqëri mund të rivendosë pasqyrat financiare sipas SNK 29 në vitin e parë që identifikon ekzistencën e hiperinflacion në ekonomine e monedhes së tij funksionale. KIFRN 7 që do të jetë i obligueshem për pasqyrat financiare te bankës në 2007, nuk pritet te ketë ndikim në pasqyrat e konsoliduara financiare.

KIFRN 8 Qëllimi i IFRS 2. Interpretimi sqaron që Standarti SNRF 2 Pagesa te bazuara ne aksione, aplikohet në marrveshje sipas të cilave një njësi kryen pagesa te tilla ne kembim te

asgjeje. KIFRN 8 që do të jetë i obligueshem për pasqyrat financiare te bankës në 2007. Banka nuk e ka percaktuar ende ndikimet potenciale te ketije interpretimi.

KIFRN 9 Rishikimi i derivativeve te perfshira. Interpretimi sqaron që trajtimi i derivativeve vlerësohet nga njësia kur Shoqëria bëhet pëe harë të parë palë e kontratës, dhe rishikimi është i ndaluar në mos ka ndryshim në termat e kontrates, i cili të modifikoje në mënyrë të rëndësishme fluksin e parase që në të kundërt do kërkohej në kontratë. KIFRN 9 që do të jetë i obligueshem për pasqyrat financiare te bankës në 2007, nuk pritet te ketë ndikim në pasqyrat e konsoliduara financiare.

KIFRN 10 Raportimi Financiar i Ndermjetem dhe Renia ne vlere ndalon kthimin e nje humbje ne vlere, te njohur me pare ne lidhje me nje investim ne kapital, goodwill, ose nje active tjeter financiare te mbajtur me kosto. KIFRN 10 do te jete i obligueshem per përgatitjen e pasqyrave financiare te Bankes per vitin 2007 dhe do te aplikohet ne goodwill, investime ne instrumentet e kapitalit dhe mjeteve financiare prej dates kur Banka fillimisht ka aplikuar matjet sipas SNK 36 dhe SNK 39 respektivisht.

KIFRN 11 SNRF 2 - Transaksionet me aksione Grupi dhe te Thesarit kerkon qe nje pagese bazuar ne askione ku nje entitet merr mallra ose sherbime ne kembim te instrumenteve te saj te kapitalit, te regjistrohet si nje transaksion me baze aksionesh, pavaresisht nga menyra si instrumentet jane perfituar. Standarti gjithashtu udhezoi se si keto marreveshje ku mallrat e sherbimet fitohen ne

kembim të instrumenteve të Grupit apo Kompanisë Meme regjistruhen si të shlyera me para ose me instrumente kapitali në pasqyrat financiare të entitetit. KIFRN 11 që do të jetë i obligueshem për përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin 2007 nuk pritet të kente ndikim në përgatitjen e ketyre pasqyrave financiare

KIFRN 12 Marrevëshjet e koncesioneve japin udhëzime në sektorin privat për disa çështje njohjeje dhe matje të ngritura në marrevëshjet e koncesionit publike-ne-private. KIFRN 12 që do të jetë i obligueshem për përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin 2007 nuk pritet të kente ndikim në përgatitjen e ketyre pasqyrave financiare

Amendime të SNK 1, Paraqitja e Pasqyrave Financiare - Informacion i publikuar mbi kapitalin. Sin jë përmirësim plotësues i lindur nga IFRS 7 (shih më sipër), standarti do kërkojë informacione shtese në lidhje me kapitalin e Bankës. Ky përmirësim do kërkojë në mënyrë të rëndësishme më tepër informacione të publikuara në lidhje me strukturën e kapitalit.

(r) Viti paraardhës

Informata krahasuese janë prezentuar duke u aplikuar në vijueshmeri politikat kontabel të Bankes. Kur ka qene e nevojshme të dhenat janë riklasifikuar për qëllime të krahasimit. (Shenimi 15)

4. Përdorimi i vlerësimeve kontabel dhe gjykimeve

Drejtimi diskutoi me Bordin e Drejtoreve zhvillimin, zgjedhjen dhe shpalesjen e politikave dhe vlerësimeve kontabel me të rëndësishme si dhe aplikimin e ketyre politikave dhe vlerësimeve. Keto paraqitje plotësojnë komentet në Shenimin mbi Drejtimin e Rrezikut Financiar (Shih

Shenimin 22).

Burimet kryesore për pasigurite në vlerësimet kontabel

Humbjet në hua dhe paradhenie

Huate dhe paradheniet vlerësohen për humbje nga renia e vlerësimit përmes politikave kontabel të përshkruara në 3 (h) (v). Huate dhe paradheniet ndaj klienteve provizionohen sipas normave fikse të caktuara nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës si dhe rishikohen në çdo datë bilanci me qëllim të përcaktimit në rast se ka indikacione për humbje nga renia e vlerësimit. Nëse kjo ekziston atëherë rivlerësohet shuma e aktiveve të mbledhshme. Me 31 Dhjetor 2005, një humbje nga renia e vlerësimit të huave dhe paradhenieve të klienteve është njohur bazuar në normat fikse të caktuara nga ACBK pas përfundimit të kontrollit të fundit të mbajtur gjatë vitit. Për pjesën e mbetur të huave shuma e mbledhshme është llogaritur në bazë të dy vlerësimeve të mëposhtme:

Vlerësimi i bazuar në ditët me vonesa (thyerje kontrate)

Shuma e mbartur e huave dhe paradhenieve të klienteve është zvogeluar me norme fikse bazuar në ditët me vonesa si më poshtë:

Ditët me vonese	% e Aplikuar
0-30 dite	1%
31-60 dite	5%
61-90 dite	20%
91-180 dite	50%
Mbi 180 dite	100%

Përcaktimi i vlerësimit të tregut

Përcaktimi i vlerësimit të tregut për aktivin dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ekziston cmimi i përafërt i tregut kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përshkruara në politiken kontabel 3(h)(iv). Për instrumente që nuk tregtohen shpesh dhe nuk ka transparencë, vlera reale është me pak objektive, dhe kërkon gjykim që varet nga likuiditeti, përqendrimi, pasiguria e tregut, supozime për cmimin dhe rreziqe të tjera që prekin instrumentin specifik.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006
(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

5. Të ardhurat neto nga interesat

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2006	2005
Të ardhura nga interesat:		
Hua dhe paradhënie klientëve	3,013	2,825
Hua dhe paradhënie bankave	424	259
	3,437	3,084
Shpenzime për interesat:		
Detyrime ndaj klientëve	1,094	745
Detyrime ndaj bankave	-	60
	1,094	805
Të ardhurat neto nga interesat	2,343	2,279

6. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2006	2005
Shërbimet bankare	872	832
Huadhënia	371	408
Garancitë	186	113
Totali	1,429	1,353

Të ardhurat nga shërbimet bankare përbëhen nga komisionet për transfertat lokale dhe ndërkombëtare, për administrimin e llogarisë, çeqet dhe shërbime të tjera.

7. Të ardhurat tjera operacionale

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2006	2005
Arkëtimi i kredive të nxjerra jashte bilancit	127	115
Të ardhura të tjera	7	1
Totali	134	116

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006
(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

8. Shpenzime te tjera operationale

	2006	2005
Shpenzimet e personelit	1,231	999
<i>Paga</i>	1,064	857
<i>Sigurime shoqerore te detyrueshme</i>	58	48
<i>Kosto te tjera te stafit</i>	109	94
Qera	401	331
Zhvlerësimi	248	179
Amortizimi	38	28
Shërbime komunale dhe karburant	84	76
Shpenzime për komunikim	84	74
Shpenzime për udhëtime	76	68
Shpenzime marketingu dhe publiciteti	79	68
Shpenzime për kancelari	58	57
Riparime dhe mirëmbajtje	40	24
Shpenzime të sigurimit	25	18
Auditimi	38	17
Shpenzime printimi	17	15
Shërbimet e IT-së	25	8
Shpenzime per keqpërdorim te mjeteve	156	-
Te tjera	73	105
Totali	2,673	2,067

Më 31 Dhjetor 2006 Banka punëson 196 punonjës (2005: 186).

Shpenzimet për keqpërdorim të mjeteve lidhen me keqpërdorimet e parave te gatshme në trezorin e degës së Gjilanit në vlerë prej 156 mijë EUR. Keqpërdorimi është bërë prej Drejtorit të degës dhe Trezoristit dhe zbuluar me 9 Dhjetor 2006. Banka ka arketuar 21 mijë në muajt në vijim por nuk e ka pakesuar humbjen për shumën e marrë.

Banka është e siguruar nga nje police BBB e Kompanise se sigurimeve "Siguria" (palë e lidhur). Banka ka raportuar dëmin prej 134 mijë EUR në kompaninë e sigurimeve dhe gjithashtu ka ngritur aktpadi kundër ish punëtorëve. Rezultatet e procesit që është në vashdim e sipër nuk mund të përcaktohen ende.

Shpenzimet e tjera përfaqësojnë anëtarësi e përfaqësime dhe taksa të tjera të paguara nga Banka.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

9. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin në Kosovë vlerësohet 20% (2005: 20%) e fitimit të tatueshëm. Më poshtë paraqitet barazimi i tatimit aktual mbi fitimin, llogaritur me normën në fuqi dhe shpenzimi për tatimin mbi fitimin.

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2006	2005
Fitimi para tatimit	789	460
Tatimi i llogaritur me 20%	158	92
Shpenzimet e tatimit ne fitim	158	92

Barazimi i tatimit të pagueshëm me tatimin e paguar për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2006 dhe 31 Dhjetor 2005 vijon si më poshtë:

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2006	2005
Tatimi i pagueshëm më 1 Janar	28	56
Tatimi i llogaritur me 20%	(104)	(120)
Shpenzimi për tatimin	158	92
Tatimi i pagueshem më 31 Dhjetor	82	28

10. Para ne arke dhe ne banka

Arka dhe bankat vijonë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Paratë në arkë	4,108	4,270
Banka Qendrore	1,709	3,088
Paratë në bankë	1,553	676
Depozitat overnight	15,927	8,310
Totali	23,297	16,344

Depozitat overnight kanë fituar interes me normë mesatare vjetore 3.61% gjatë vitit 2006 (2005: 2.33%). Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore nuk përfitojnë interes.

Llogaria rrjedhëse në LHB Internationale nuk përfiton interes ndërsa llogarite rrjedhëse të mbajtura në American Bank of Albania dhe Raiffeisen Bank fitojnë interes me normë mesatare vjetore prej 2.14 % në 2006 (1.452% në 2005).

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

Llogaritë mbahen ne bankat korrespondente si më poshtë:

	2006		2005	
	Rrjedhese	Overnight	Rrjedhese	Overnight
LHB Internationale Handelsbank, Gjermani	845	7,477	68	8,310
Raiffeisen Bank, Austri	40	8,450	228	-
American Bank of Albania, Shqiperi	668	-	380	-
Total	1,553	15,927	676	8,310

11. Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore

Rezerva e Detyrueshme me Bankën Qendrore paraqet rezervën e likuiditetit që detyrimisht mbahet në Bankën Qendrore sipas rregullores së CBAK-së. Më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005 kjo rezervë është caktuar në 10% të balancit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave të klientëve. Për vitin e mbyllur 2006 norma e interesi të fituar në rezervën e detyrueshme sillet prej 1.25-2.25% ne vit (2005: 1% ne vit).

12. Hua dhe paradhënie bankave

Huatë dhe paradhëniet ndaj bankave detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Depozitat e afatizuar	-	2,500
Llogaritë e tjera	322	307
Interesi i përlllogaritur	-	4
Totali	322	2,811

Depozitat me LHB Internationale Handelsbank në Gjermani më 31 Dhjetor 2005 kanë maturitet 1 vjeçar dhe jane mbyllur me 5 Qershor 2006. Në 2005 dhe 2006 depozitat me këtë bankë fitojnë interes vjetor me normë 2.8%.

Llogaritë e tjera përfaqësojnë llogari të bllokuara si garanci në Banken Amarikane te Shqiperise për kartat American Express dhënë Bankës dhe klientëve të saj.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

13. Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Hua afatgjata	14,640	13,768
Hua afatshkurtra	5,102	7,203
Overdraftet	2,152	1,147
Interesi i përlogaritur	247	199
Rezerva për humbjet nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve	(1,005)	(1,146)
Totali	21,136	21,171

Huatë afatgjatë kanë maturitet me mbi 12 muaj.

Lëvizjet në rezervën për humbjet nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve vijojnë si më poshtë:

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2006	2005
Më 1 Janar	1,146	386
Humbja nga rënia në vlerë (neto nga rimarrjet)	293	1,181
Huatë e nxjerra jashtë bilancit	(434.00)	(421.00)
Tatimi i pagueshem më 31 Dhjetor	1,005	1,146

14. Investimet në prona

Investimet në prona paraqesin pasurinë që më parë është lënë si peng nga huamarresit si garanci për huatë e marra nga Banka. Pronësia për këto pasuri është kaluar te banka gjatë vitit 2006, për shkak të paaftësisë së huamarresit për të paguar huanë.

Drejtimi ka vendosur të mbaje këte pasuri si investime në vijim dhe jo të perdore ato për aktivitetet kryesore ose që ta shese për një periudhë të shkurtër kohore.

Investimet në prona	
Kosto	
Shtesa	460
Me 31 Dhjetor 2006	460
Zhvlerësimi i akumuluar	
Shpenzime për vitin	17
Me 31 Dhjetor 2006	17
Vlera kontabel neto	
Me 31 Dhjetor 2006	443

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

Me 1 Shkurt 2007 Drejtimi ka vendosur te aprovoje kerkesen e ish-pronarit te pasurise qe te bleje pasurine brenda nje viti prej momentit te marrjes se vendimit. Nese shitja nuk do te ekzekutohet brenda nje viti nga data e marrjes se vendimit, Drejtimi do te konsideroje vendimin per mbajtjen e pasurise si investim ne vijim, t'a shese ate apo ta perdore per aktivitet kryesore.

15. Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara detajohen si më poshtë: Përmirësimet e objekteve

	Përmirësimet e objekteve me qera	Furnitura, instalime dhe pajisje	Pajisje IT	Automjete	Totali
Kosto					
Më 1 Janar 2005	235	463	326	27	1,051
Shtesa	8	391	197	75	757
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(1)	(1)	-	(2)
Më 31 Dhjetor 2005	243	853	522	102	1,720
Më 1 Janar 2006	243	853	522	102	1,720
Shtesa	-	57	34	28	119
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(2)	(8)	-	(10)
Më 31 Dhjetor 2006	243	908	548	130	1,829
Zhvlerësimi i akumuluar					
Më 1 Janar 2005	108	167	123	5	403
Shpenzimi për vitin	48	74	49	8	179
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(1)	-	-	(1)
Më 31 Dhjetor 2005	156	240	172	13	581
Më 1 Janar 2006	156	240	172	13	581
Shpenzimi për vitin	38	103	68	22	231
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(1)	(3)	-	(4)
Më 31 Dhjetor 2006	194	342	237	35	808
Vlera kontabël, neto					
Më 1 Janar 2005	127	296	203	22	648
Më 31 Dhjetor 2005	87	613	350	89	1,139
Më 31 Dhjetor 2006	49	566	311	95	1,021

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

me qera lidhen me shpenzimet e kryera në degët Ferizaj, Prizren (në vitin 2002) Prishtinë, Pejë, Mitrovicë (në vitin 2003), në Gjilan (në vitin 2004) si dhe përmirësimet në degën e Prizrenit dhe Zyrat Qëndore (në vitin 2006).

Nuk ka aktive të bllokuara si garanci më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005.

16. Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivët e qëndrueshme të patrupëzuara më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005 detajohen si më poshtë:

	Programe Kompjuterike
Kosto	
Më 1 Janar 2005	132
Shtesa	96
Më 31 Dhjetor 2005	228
Më 1 Janar 2006	228
Shtesa	6
Më 31 Dhjetor 2006	234
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 Janar 2005	60
Shpenzimi për vitin	28
Më 31 Dhjetor 2005	88
Më 1 Janar 2006	88
Shpenzimi për vitin	38
Më 31 Dhjetor 2006	126
Vlera kontabël, neto	
Më 1 Janar 2005	72
Më 31 Dhjetor 2005	54
Më 31 Dhjetor 2006	108

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

17. Detyrime ndaj bankave

Detyrimet ndaj bankave më 31 Dhjetor 2005 vijojnë si më poshtë:

Banka	Shuma	Maturiteti	Norma e interesit (p.a.)
LHB Internacionale Handelsbank, Gjermani	2,503	12 muaj	2.80%
Totali	2,503		

18. Detyrime ndaj klientëve

Llogaritë e klientëve për bizneset, sipërmarrësit privatë dhe individët detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Llogaritë rrjedhëse		
Në EUR	12,401	10,751
Në monedhë tjetër	1,139	315
Dapozitat me afat		
Në EUR	29,748	25,195
Në monedhë tjetër	-	-
Interesi i përlogaritur	625	376
	43,913	36,637

Llogaritë rrjedhëse nuk fitojnë interes.

Interesat për depozitat më 31 Dhjetor 2006 vijojnë si më poshtë:

1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 vjet	3 vjet	5 vjet
%	%	%	%	%	%	%	%
2.3	2.5	3.1	4-4.55	4.2	4.5	4.6-4.8	5

Interesat për depozitat më 31 Dhjetor 2005 vijojnë si më poshtë:

1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 vjet	3 vjet	5 vjet
%	%	%	%	%	%	%	%
2.3	2.5	3.1	3.5-4.5	4.2	4.5	4.6-4.8	5

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

19. Detyrimet të tjera

Detyrimet e tjera përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Taksa të tjera të pagueshme	52	43
Sigurimet shoqërore	11	12
Shpenzime të përlogaritura	42	88
Totali	105	143

20. Kapitali Aksioner

Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Bankës është i ndarë në 18,457 aksione të zakonshme me vlerë (më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005) EUR 256 secila, gjithësej EUR 4,725,031.

Në përputhje me Rregullin XXI mbi "Kapitalit Minimal të Bankës" autorizuar nën Seksionin 5 të Rregullores 1999/21 të publikuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, kapitali minimal aksioner për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë EUR 5 milion.

Aksionet japin te drejten e marrjes se dividendit dhe kane te drejta te njejta vote.

Kapitali rregullator i nivelit te pare eshte 6,620 mije EUR (2005: 5,989 mije EUR). Raporti i mjaftueshmerise se kapitalit qe perfaqeson raportin e totalit te kapitalit mbi aktivin eshte 13.05% (2005: 13.22%), ndersa minimumi i kerkuar eshte 12% (2005: 12%). Lista e aksionerëve kryesor të Bankës më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005 vijon si më poshtë:

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

	31 Dhjetor 2006		31 Dhjetor 2005	
	Përqindja e pronësisë	Shuma	Përqindja e pronësisë	Shuma
<i>Lista e aksionerëve</i>				
	%	(EUR '000)	%	(EUR '000)
Behgjet Pacolli	49.09	2,320	49.09	2,320
Hasan Hajdari	13.10	619	13.10	619
Xhabir Kajtazi	8.58	406	8.57	405
Raif Rexhepi	6.81	322	7.87	372
Zyhra Hajdari	5.71	270	5.71	270
Ismet Gjoshi	4.23	200	4.23	200
Qerim Ramadani	3.33	157	3.33	157
Selim Pacolli	1.73	82	1.73	82
Elkos	1.60	76	1.60	76
Xhevdet Visoka	1.06	50	-	-
Union	0.67	31	0.67	31
Ibrahim Bytyqi	0.63	30	0.63	30
Nesret Gashi	0.58	27	0.58	27
Gafur Neziri	0.50	24	0.50	24
Lesna	0.27	13	0.27	13
Dukagjini operative	0.26	12	0.26	12
Hc 'jatex'	0.22	11	0.22	11
Elektromotorri	0.20	9	0.20	9
Intergrafika	0.16	8	0.16	8
Emin Duraku	0.15	7	0.15	7
Union VI	0.13	6	0.13	6
Valoni Impex	0.13	6	0.13	6
Inova	0.10	5	0.10	5
Hc 'Metaliku'	0.09	4	0.09	4
Të tjerë	0.67	30	0.68	31
	<u>100.00</u>	<u>4,725</u>	<u>100.00</u>	<u>4,725</u>

Rezerva e përgjithshme

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të Bankës dhe aprovimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve më 28 Prill 2004, fitimi i pashpërndarë më 31 Dhjetor 2003 EUR 507,771 u përvetësua i tëri më 8 Qershor 2004. Shuma prej EUR 406,217 iu shpërnda aksionerëve të vjetër në formën e aksioneve të reja dhe pjesa tjetër prej EUR 101,554 kaloi në Rezerva e përgjithshme.

Qëllimi i rezervës është të mbulojë risqet e përgjithshme me të cilat përballet Banka gjatë aktivitetit të saj normal.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

21. Garanci dhe angazhime

Garancitë dhe angazhimet përfshijnë garancitë dhënë klientëve. Bilanci më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005 detajohet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Të siguruara me depozita	143	86
Të sigurura me letra garancie	1,577	147
Të pasiguruara	530	792
Totali	2,250	1,025

Garancitë e marra nga institucionet financiare përfshijnë shumën EUR 1,577 mijë, garanci e marrë nga LHB Internationale Handelsbank AG, në Gjermani. (2005: EUR 147 mijë) Banka emeton garanci në favour të klientëve të saj. Këto instrumenta i nënshtrohen riskut të kredisë ashtu edhe si huatë e disbursura. Sipas vlerësimit të drejtuesve të Bankës, nuk pritet të ndodhë të ndodh dëm material lidhur me garancitë në fuqi më 31 Dhjetor 2006 dhe rrjedhimisht nuk do të krijohet rezerva për të tilla humbje në pasqyrat financiare.

Çështjet gjyqësore

Gjatë aktivitetit normal të saj Banka përballlet me pretendime ndaj/të palëve të treta dhe çështje gjyqësore. Sipas opinionit të drejtuesve të Bankës zgjidhja e këtyre çështjeve gjyqësore nuk do të ketë ndikim në rezultatin financiar të Bankës.

Angazhimet kontraktuale për qeranë operationale

Banka hyn në kontrata qeraje për zyrat e saj. Këto kontrata janë për qera operative dhe jo të kancelueshme:

	31 Dhjetor 2006	31 Dhjetor 2005
Më pak se 1 vit	285	351
Nga 1 deri në 5 vjet	565	787
Totali	850	1,138

22. Administrimi i riskut financiar

Për shkak të natyrës së tyre, aktivitetet e bankave lidhen kryesisht me përdorimin e instrumentave financiarë. Instrumenti financiar është çdo kontratë që çon në lindjen e të drejtave për arkëtim parash apo aktive të tjera financiare nga një palë e tretë (aktiv financiar), ose në lindjen e detyrimit për të paguar para apo dorëzuar aktive të tjera financiare një palë të tretë (detyrim financiar).

Instrumentat financiarë shfaqin nivele të caktuara risku për Bankën. Risku më i rëndësishëm që lidhet me instrumentat financiare diskutohet në vijim.

(i) Risku i normës së interesit

Operacionet e Bank i nënshtrohen riskut që vjen nga fluktuacionet e normës së interesit

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

për sa kohë aktivet dhe detyrimet që sjellin interes maturohen apo riçmohen në momente kohore dhe/ose në shuma të ndryshme. Për të reduktuar riskun e normës së interesit Banka monitoron vazhdimisht lëvizjet e tregut financiar. Megjithatë efekti aktual ndikohet edhe nga faktorë të tjerë, duke përfshirë këtu mundësinë e kryerjes së pagesave më pare ose më vonë se datat kontraktuara, variacionet në ndjeshmërinë e riçimit ndaj normës së interesit si dhe monedhat e ndryshme.

(a) Informacion për Yield-in efektiv

Tabela e mëposhtme paraqet Yield-et efektive mesatare për përkatësitë më të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005:

Norma mesatare e ponderuar e interesit	EUR		USD		CHF	
	2006	2005	2006	2005	2006	2005
31 Dhjetor						
Aktivët						
Arka dhe bankat	2.45	-	5.27	2.15	1.5	-
Llogaritë me Bankën Qendrore	2.25	1	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie bankave	-	2.23	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	14.41	14.66	-	-	-	-
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	-	2.8	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	3.96	3.53	0.7	0.7	0.43	0.43

(b) Analiza e riçimit të nomave të interesit

Tabela e mëposhtme paraqet momentet e riçimit të normave të interesit për aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës. Aktivet dhe detyrimet me norma interesi fikse janë raportuar në përputhje me datat e ripagimit së tyre.

31 Dhjetor 2006

	1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
Aktivët							
Arka dhe bankat	17,471	-	-	-	-	5,826	23,297
Banka Qendrore	-	-	-	-	4,329	-	4,329
Hua bankave	-	-	-	-	-	322	322
Hua klientëve	780	12	212	5,917	13,968	247	21,136
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	64	64
Totali	18,251	12	212	5,917	18,297	6,459	49,148
Detyrimet							
Detyrimet ndaj klienteve	119	9,411	92	14,169	6,582	13,540	43,913
Detyrime të tjera dhe taksa	-	-	-	-	-	187	187
Totali	119	9,411	92	14,169	6,582	13,727	44,100
Pozicioni neto	18,132	(9,399)	120	(8,252)	11,715	(7,268)	5,048
Pozicioni neto kumulativ	18,132	8,733	8,853	601	12,316	5,048	-

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

	1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Pa interes	Totali
Aktivët							
Arka dhe bankat	8,918	-	-	-	-	7,426	16,344
Banka Qendrore	-	-	-	-	3,636	-	3,636
Hua bankave	-	-	-	2,500	-	311	2,811
Hua klientëve	1,694	310	316	5,727	12,141	983	21,171
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	59	59
Totali	10,612	310	316	8,227	15,777	8,779	44,021
Detyrimet							
Detyrime ndaj bankave	-	-	-	2,500	-	3	2,503
Detyrime ndaj klientëve	2,834	3,445	6,277	9,413	3,226	11,442	36,637
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	171	171
Totali	2,834	3,445	6,277	11,913	3,226	11,616	39,311
Pozicioni neto	7,778	(3,135)	(5,961)	(3,686)	12,551	(2,837)	4,710
Pozicioni neto kumulativ	7,778	4,643	(1,318)	(5,004)	7,547	4,710	-

(ii) Risku i kreditimit

Aktiviteti i kreditimit dhe ndërmjetësimi financiar e ekspozon Bankën ndaj riskut të kreditimit. Në këtë kontekst risku qëndron në mundësinë e mosplotësimit të angazhimeve kontraktore nga palët e treta. Administrimi i këtij risku kryet nëpërmjet analizave periodike të rentabilitetit të huamarrësve të ndryshëm si dhe klasifikiminn e tyre sipas riskut që mbartin. Një formë e drejtpërdrejtë e administrimit të riskut të kreditimit është përfitimi i kolateraleve dhe garancive të tjera.

Risku kryesor lind nga huatë dhe paradhëniet. Vlera e ekspozimit është e barabartë me vlerën kontabël neto të këtyre aktiveve në Bilanc. Angazhimet e financimit shtesë, garancitë e emetura në favor të klientëve dhe angazhimet e tjera jasht bilancit përbëjnë gjithashtu risk (shiko shënimin 21).

Përqëndimi i riskut të kreditimit për zërat e bilancit apo jashtë tij ekziston edhe për palët e treta kur këta kanë karakteristika të ngjashme. Kjo do të shkaktonte reagimin në mënyrë të njëjtë ndaj dukurive ekonomike dhe paftësinë e njëkohëshme për të plotësuar detyrimet e tyre kontraktore. Risku i kreditimit ka përqëndrim më të madh në rastin e huave dhe paradjënieve dhënë klientëve, angazhimeve për financim si dhe garancive të dhëna.

Me 31 Dhjetor 2006 15 kredimarresit me te medhenj te Bankes perfaqesojne 36% te totalit te portofolit te kredise.

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e huave dhe paradhënieve dhënë klientëve sipas sektorëve të industrisë, pa përfshirë interesin e përlogaritur:

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

Sektori i Industrisë	31 Dhjetor 2006	%	31 Dhjetor 2005	%
Tregëti me shumicë	13,214	60	13,967	63
Produhim	1,859	8	2,368	11
Konsum	2,808	13	2,624	12
Shërbime	2,096	9	1,427	6
Hotele dhe restorante	223	1	566	3
Agrikulturë	120	1	14	0
Udhëtim	1,446	7	1,090	5
Të tjera	128	1	62	0
	21,894	100	22,118	100

Huatë dhe paradhëniet e klientëve në fund të vitit 2006, janë siguruar nëpërmjet hipotekave, lënies peng të makinerive, pajisjeve, si dhe garancive personale si në vijim:

	31 Dhjetor 2006	%	31 Dhjetor 2005	%
Hipoteka	12,547	57	15,130	68
Depozita në para	708	3	170	1
Pengje	6,562	30	6,232	28
Mikse (hipoteka dhe pengje)	1,261	6	586	3
Garanci personale	816	4	-	-
Total	21,894	100	22,118	100

(iii) Risku i normave të këmbimit valutor

Kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj ekspozon Bankën kundrejt riskut që vjen nga fluktacionet kursit të këmbimit. Meqënëse pasqyrat financiare prezantohen në EUR, lëvizjet e kursit të këmbimit të monedhave të tjera kundrejt EUR kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

Ekspozimi ndaj transaksioneve vjen nga prezenca e aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të ndryshme nga ajo e prezantimit të pasqyrave financiare (në këtë rast: EUR). Fitimet/(humbjet) e krijuara regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të ndryshme nga EUR më 31 Dhjetor 2006 vijon si më poshtë:

(në EUR)

	31 Dhjetor 2006				
	EUR	USD	CHF	GBP	Total
Aktivët					
Paraja dhe ekuivalentet e saj	20,757	1,523	1,014	3	23,297
Llogaritë me Bankën Qendrore	4,329	-	-	-	4,329
Hua dhe paradhënie bankave	322	-	-	-	322
Hua dhe paradhënie klientëve	21,136	-	-	-	21,136
Aktive të tjera	64	-	-	-	64
Totali aktiveve	46,608	1,523	1,014	3	49,148
Detyrimet dhe kapitali i aksionerëve					
Detyrimet ndaj klienteve	42,774	355	781	3	43,913
Detyrime të tjera dhe taksa e pagueshme	187	-	-	-	187
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner	42,961	355	781	3	44,100
Pozicioni valuator neto	3,647	1,168	233	-	5,048

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

(në EUR)

	31 Dhjetor 2005			
	EUR	USD	GBP	Total
Aktiva				
Paraja dhe ekuivalentet e saj	15,665	629	50	16,344
Llogaritë me Bankën Qendrore	3,636	-	-	3,636
Hua dhe paradhënie bankave	2,811	-	-	2,811
Hua dhe paradhënie klientëve	21,171	-	-	21,171
Aktive të tjera	59	-	-	59
Totali i aktiveve	43,342	629	50	44
Detyrimet dhe kapitali i aksionerëve				
Detyrime ndaj bankave	2,503	-	-	2,503
Detyrime ndaj klientëve	36,322	253	62	36,637
Detyrime të tjera dhe taksa e pagueshme	171	-	-	171
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner	38,996	253	62	39,311
Pozicioni valuator neto	4,346	376	(12)	4,710

(iv) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit lind si rrjedhojë e politikës së administrimit të fondeve dhe administrimit të pozicionit. Përfshin si riskun e paaftësisë për të investuar në aktive me maturime të përshtatshme dhe për të likuiduar një aktiv me çmim të arsyeshëm si dhe paaftësinë për të përmbushur detyrimet financiare në kohë.

Fondet krijohen nga përdorimi i një rangu të gjerë instrumentash duke përfshirë depozitat, detyrime të tjera të evidentueshme në kontrata si dhe kapitalin aksioner. Kjo rrit fleksibilitetin në sigurimin e fondeve. Banka përpiqet në maksimum për të ruajtur balancën midis fondeve të qëndrueshme dhe fleksibilitetit nëpërmjet financimeve me maturime të ndryshme. Banka bën vazhdimisht vlerësim të riskut të likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar vazhdimisht nevojat për fonde në përputhje me strategjinë e përgjithshme të Bankës.

Gjithashtu Banka mban një vlerë të caktuar aktivesh likuide në portofol si pjesë e strategjisë së saj për administrimin e riskut.

Më 31 Dhjetor 2006 pesëmbëdhjete depozitat më të mëdha nga bizneset dhe individët përfaqësojnë 47.67% të totalit të depozitave nga klientët (2005: 48.96%).

Tabela në vazhdim paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës grupuar sipas maturitetit të mbetur (bazuar në periudhat deri në ripagim).

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006
(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

31 Dhjetor 2006						
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktiva						
Paraja dhe ekuivalentet e saj	23,297	-	-	-	-	23,297
Llogarirë me Bankën Qendrore	-	-	-	-	4,329	4,329
Hua dhe paradhënie bankave	322	-	-	-	-	322
Hua dhe paradhënie klientëve	789	12	215	5,987	14,133	21,136
Aktive tjeter	64	-	-	-	-	64
Totali	24,472	12	215	5,987	18,462	49,148
Detyrimet						
Detyrime ndaj klientëve	13,659	9,411	92	14,169	6,582	43,913
Detyrime të tjera	187	-	-	-	-	187
Totali	13,846	9,411	92	14,169	6,582	44,100
Pozicioni i likuiditetit më 31 Dhjetor 2006	10,626	(9,399)	123	(8,182)	11,880	5,048
Pozicioni kumulativ më 31 Dhjetor 2006	10,626	1,227	1,350	(6,832)	5,048	

31 Dhjetor 2005						
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Aktiva						
Arka dhe bankat	16,344	-	-	-	-	16,344
Llogaritë me Bankën Qendrore	-	-	-	-	3,636	3,636
Hua dhe paradhënie bankave	311	-	-	2,500	-	2,811
Hua dhe paradhënie klientëve	2,677	310	316	5,727	12,141	21,171
Aktive të tjera	59	-	-	-	-	59
Totali	19,391	310	316	8,227	15,777	44,021
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	-	-	-	2,503	-	2,503
Detyrime ndaj klientëve	14,276	3,445	6,277	9,413	3,226	36,637
Detyrime të tjera	171	-	-	-	-	171
Totali	14,447	3,445	6,277	11,916	3,226	39,311
Pozicioni i likuiditetit më 31 Dhjetor 2005	4,944	(3,135)	(5,961)	(3,689)	12,551	4,710
Pozicioni kumulativ më 31 Dhjetor 2005	4,944	1,809	(4,152)	(7,841)	4,710	

23. Pasqyrimi në vlerë reale

Pasqyrimi në vlerë reale (fair) bazohet në instrumentat ekzistues financiare të bilancit pa u përpjekur të vleresojë në avancë vlerën e ardhme të biznesit dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk konsiderohen si instrumenta financiare.

Hua dhe paradhënie Institucioneve financiare

Huatë dhe paradhëniet dhënë bankavepërfshijnë vendosje bankë me bankë të pamaturu-

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

ara ende. Meqënëse depozitat njëditore janë depozita afatshkurtra dhe me norma të luhatshme vlera e tyre reale konsiderohet e barabartë me vlerën kontabile.

Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve paraqiten me vlerë bruto minus fondin rezervë për humbjet. Porofoli i kredisë së Bankës ka një vlerë reale të barabartë me vlerën kontabile për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër dhe të normave të interesit të përafërta me normat e tregut.

Detyrim ndaj bankavedhe klientëve

Vlera reale e depozitave pa afat, ku përfshihen depozitat që nuk fitojnë interes, është e barabartë me shumën e pagueshme me kërkesë të klientit. Vlera reale e depozitave me afat më 31 Dhjetor 2006 është EUR 30, 405 mijë, ndërsa vlera e tyre kontabël është EUR 30,373 mijë.

Vlera reale e depozitave me afat më 31 Dhjetor 2005 është EUR 27,240 mijë, ndërsa vlera e tyre kontabël është EUR 27,695 mijë. Vlera e tregut për depozitat e afatizuar më 31 Dhjetor 2006 është më e vogël se vlera e tyre kontabël për shkak të një rritje në normën e interesit të depozitave në 4.55% në Dhjetor të vitit 2006.

24. Transaksionet me palët e lidhura

Gjatë vitit 2006 Banka është përfshirë në transaksione me kompanitë në pronësi të dhe të lidhura me Behgjet Pacolli, një nga aksionerët kryesor të Bankës.

Gjithashtu gjatë vitit 2006 Banka ka paguar në favor të Bordit të Drejtorëve të saj një shumë totale prej EUR 41 mijë (2005: EUR 28 mijë).

Transaksionet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë (në EUR '000):

Lloji i transakionit	Bordi i Drejtorëve		Aksionerët	
	2006	2005	2006	2005
Hua dhe paradhënie:				
Hua dhe paradhënie në fillim të vitit	35	5	1,222	520
Hua të akorduara gjatë vitit	3	44	2,012	2,198
Hua të ripaguara gjatë vitit	(26)	(14)	(1,747)	(1,496)
Hua dhe paradhënie në fund të vitit	12	35	1,487	1,222
Detyrime ndaj klientëve:				
Detyrime ndaj klientëve në fillim të vitit	10	91	61	21
Detyrime të lindura gjatë vitit	380	29	35,032	45,515
Detyrime të paguara gjatë vitit	(379)	(110)	(30,887)	(45,475)
Detyrime ndaj klientëve në fund të vitit	11	10	4,206	61
Blerje e mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	56
Të ardhurat për vitin e mbyllur më				
Të ardhurat nga interesat	4	2	175	56
Tarifa dhe komisione	-	1	36	41
Shpenzime për interesat	1	1	109	58
Shpenzime të tjera	41	28	-	-

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2006

(Në EUR '000, përveç kur shkruhet ndryshe)

Totali i shperblimit te drejtuesve kyç te Bankes qe perfshihet ne shpenzimet operative eshte si me poshte (Shenimi 8):

	2006	2005
Te mira afat shkurtra per punonjesit	75	61
	<u>75</u>	<u>61</u>

25. Ngjarjet pas mbylljes se bilancit

Nuk ka ngjarje pas mbylljes se bilancit që mund kërkojnë rregullime apo paraqitje informacioni shtesë në pasqyrat financiare të vitit 2006.

BEXCARD

kartela më e vlefshme në portofolin tuaj!



Duke ju konsideruar Juve si pjesën më të vlefshme të Bankës Ekonomike, mundohemi që gjithmonë t'ju sjellim risi, që ngrisin kualitetin e shërbimeve dhe dëshmojnë seriozitetin tonë dhe kujdesin e vazhdueshëm ndaj jush.

BeXcard përbën një nga risitë tona që do t'ju lehtësojë qasjen në të hollat tuaja dhe do t'ju mundësojë tërheqje të hollash përgjatë 24 orëve, çdo ditë të javës.

Aplikoni menjëherë dhe shfrytëzoni mundësitë që ua ofrojmë ne!

Adresat ku janë të vendosur Bankomatët:

Prishtinë

rr. Migjeni nr.1
rr. Nëna Terezë 25b
Tel. 038 244 396

Mitrovicë,

Rr. Agim Hajrizi nr.26,
Tel.&Fax.: 028/34 700

Pejë

rr. "122" nr.2
Tel.&Fax.: 039/434 815

Gjakovë

rr. UÇK-së, p.n.
Tel.&Fax.: 0390/324 861

Prizren

sheshi "Skenderbeu" p.n.
Tel.&Fax.: 029/42 234

Ferizaj

rr. Bislim Rexhepi p.n.
Tel.&Fax.: 0290/321 260

Gjilan

rr. Adem Jashari p.n.
Tel.&Fax.: 0280/323 609

Ekspozitura në Burim (Istog)

rruga kryesore p.n.
Tel.&Fax.: 039/51 339

Ekspozitura në Rahovec

rr. "Sylejman Vokshi" nr.2
Tel.:029/ 77 902

PARTNERËT AFARISTË MË TË RËNDËSISHËM TË BANKËS EKONOMIKE

MOST IMPORTANT BUSINESS PARTNERS OF THE BANKA EKONOMIKE



“MABETEX GROUP”, LUGANO/PRISHTINË



SHOPPING CENTER “YLLI BEC”, PRISHTINË



“ELKOS GROUP”, PEJË/PRISHTINË



KOMPANIA “DUKAGJINI”, PEJË



EXPORT-IMPORT “UNION”, VUSHTRIA



N.T.P. “LIRIDONI”, PEJË